


Pse romani i humbur i G.G.Márquez-it po botohet kundër dëshirës së tij

## BOTIMI I ROMANIT “SHIHEMI NË GUSHT” SI NJË NGJARJE LETRARE HISTORIKE

Nga Nawaid Anjum

Përktheu Granit Zela



Romani i panjohur i G. G. Markezit do të botohet në të gjithë botën (në shqip nga Onufri), në të njëjtën ditë:

6 mars 2024

Nga familja Kamsi kam njohur vetëm Miryam, ose Milën sikundër më kërkoi ta thërrisja. Nëpërmjet emocioneve të saj tekta më rrëfente historinë e familjes, shkrova këtë përkujtim për Willy Kamsin, më së pari dhe gjithë brezin e fundit të dinastisë së tij, pasardhëse e Engjëllorëve të Drishtit

### NJË PËRVIJIM HISTORIK I FAMILJES KAMSI NËPËRMJET EMOCIONEVE TË MIRYAM

nga Andreas Dushi

(fq. 6)



### BESNIK MUSTAJA: politikan që shkruante romane apo shkrimtar që merrej me politikë?

Intervistë e botuar në suplementin kulturor të gazetës më të madhe saudite «Okaz», 17 shkurt 2024.

Intervistoi Ali Fajim

Përvoja në politikë më ka dhënë mundësinë ta vëzhgoj nga brenda si funksionon makineria e pushtetit politik dhe ta vërej drejtpërdrejtë sa e pamëshirshme është ajo. Rrjedhimisht, kam kuptuar më mirë përse njeriu si individ duket aq i vogël dhe i dobët përballë kësaj makinerie. Në këtë kuptim, përvoja në politikën e niveleve të larta më ka shërbyer dhe vazhdon të më shërbejë ndjeshëm për ta bërë më të vërtetë e më realiste letërsinë që shkruaj.

(fq. 4)

### SHËNIME MBI LIBRAT

Ribotohet libri “Lufta civile në Shqipëri 1943-1945”

#### KONTRIBUT I ÇMUAR I HISTORIANIT URAN BUTKA

nga Erald Kapri

(fq. 12)

#### FATE VELAJ, ARTISTI, SHKRIMTARI DHE NJERIU “UNIVERSALIS”

nga Dr. Bledar Kurti

(fq. 11)

#### ÇMENDURIA POETIKE E EPMIRIZMIT EKZISTENCIAL

nga Pol Milo

(fq. 9)

“S’e paskëshim ditur bukurinë tonë” nga Ardita Jatru

#### FËMIJA I BRENDSHËM - PAJTIMI I POETES

nga Ballsor Hoxha

(fq. 10)

Vëllimi Heraldikët e borës, të Niko Kacalidhës

#### NJË POEZI E VËRTETË

nga Diamanta Zalta


(fq. 19)

Para botimit të romanit  
“Shihemi në gusht”,  
i biri i Markezit,  
Rodrigo García, flet  
për demencën e babait,  
të bijën që e mbajti të  
fshehtë dhe ngjarjen  
kur e goditi në fytyrë  
Mario Vargas Llosa  
**JETA E FSHEHTË E  
G.G. MARQUEZ**

Helena de Bertodano, *The Sunday Times*

Përktheu Enxhi Hudhri

(fq. 20)



### BIBLIOTEKË

Nuri Plaku

*Dielli perëndon në kindat e*

(fq. 16)

*fustanit tënd*

(fq. 18)

Qerim Raqi

*Vitet pa ty*

Thomas Brasch

*Shpesh je ti ai, që unë dua*

(fq. 23)

Përktheu Fatmir Alimani

Arben Meksi

*Karikatura e të shtunës*

(fq. 17)

### QYTETI I TË VDEKURVE

ese nga Stefan Çapaliku

(fq. 14)

### LIBRI DHE MINISTRIA E RE ME TRE PORTOFOLE

Nga Xhevair Lleshi

Unë s’kam punë me emërtimet e ministrive, por do t’me pëlqente të ishin më mirë nja katër ministri dhe njëra vetëm gjigante, ajo e brendshme, dhe të ashtuquajturat ministri të tanishme të ktheheshin në drejtori, siç ndodhi tani me kulturën.

(fq. 8)

*Shihemi në gusht*, romani i rizbuluar si një prej paraardhësve të bumit të Amerikës Latine të viteve 1960, do të botohet në të gjithë botën në të njëjtën ditë: 6 mars 2024.

Në *Shihemi në gusht* tregohet historia e një gruaje, Ana Magdalena Bach-ut, e cila bën shtegtimin e përvitshëm në një ishull për të përkujtuar përvjetorin e vdekjes së nënës, një udhëtim që kthehet në zbulim të lirisë dhe keqardhjes, si dhe i mistereve të dashurisë.

Shkrimtari legjendar kolumbian Gabriel García Márquez – romani i rizbuluar i të cilit *Shihemi në gusht* do të botohet pas vdekjes, pavarësisht nga dëshira e tij e shprehur qartë për të kundërtën – mbështetet te kujtesa; ishte instrumenti që ai përdorte, si shumë shkrimtarë të tjerë para dhe pas tij. I njohur për ndërthurjen e ndërlikuar të kujtesës me kohën, dhe reales me fantastiken, në romanet *Njëqind vjet vetmi*, *Dashuri në kohën e kolerës* dhe *Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar*, vitet e muzgut të jetës u shënjuan nga një dukuri mizore dhe ironike: ai, shkrimtari i kujtesës - i kujtesës kolektive të qytezave dhe familjeve - filloi të humbiste të tijën.

Ulja e vazhdueshme e nivelit të aftësive njohëse shkaktoi paaftësinë për të shkruar, një goditje për shkrimtarin i cili së bashku me Jorge Luis Borges-in, Alejo Carpentier-in, Juan Carlos Onetti-in dhe Augusto Roa Bastos-in, ishte një nga shkrimtarët pararojë të bumit të Amerikës Latine në vitet 1960, teknikat moderniste të të cilit si realizmi magjik kishin mahitur botën. Para se të vdiste në vitin 2014, për shkak të pneumonisë, në moshën 87-vjeçare, García Márquez-i po luftonte me demencian dhe gjithashtu po punonte për një roman të ri, të cilin ai nuk donte që bota ta lexonte.

Duke pasur probleme me kujtesën, Gabo - siç e quanin me dashuri admiruesit në botën spanjolle dhe më gjerë - vendosi që kjo vepër e re të mos botohej pas vdekjes. Djemtë e Márquez-it, Rodrigo (64 vjeç, regjisor) dhe Gonzalo García Barcha (59, dizajner grafik), kanë vendosur ta botojnë librin 10 vjet pas vdekjes së laureatit të Nobelit.

### Një rrëfenjë për lirinë dhe dëshirën femërore

I përkthyer në anglisht nga I përkthyesja kanadeze Anne McLean *Shihemi në gusht* është përshkruar si “një rrëfenjë e jashtëzakonshme dhe e thellë e lirisë dhe dëshirës femërore” nga botuesi Viking, një degë e Penguin Random House Britani e Madhe, e cila do të nxjerrë në treg romanin më 6 mars 2024.

## Pse romani i humbur i G.G.Márquez po botohet kundër dëshirës së tij

# BOTIMI I ROMANIT “SHIHEMI NË GUSHT” SI NJË NGJARJE LETRARE HISTORIKE

Nga Nawaid Anjum

Ballina e pasme e romanit dhe data e botimit në gjuhën angleze u zbuluan në Panairin e Librit në Frankfurt të mërkurën (18 tetor). Më herët, në maj të këtij viti, Viking kishte njoftuar se kishte blerë të drejtat e romanit të pabotuar, *En Agosto Nos Vemos*. Isabel Wall, drejtoresha editoriale e Viking, fitoi të drejtat për në Britani dhe Komonuelth me një ceremoni të posaçme nga Agjencia Letrare “Carmen Balcells” në Barcelonë, e cila përfaqëson Márquez-in.

Botimi i romanit “të humbur” është

cilësuar si një “ngjarje letrare historike” dhe një bashkëpunim global midis botuesve, duke përfshirë botuesin Knopf, degë e Penguin Random House SHBA dhe botuesit Random House në Spanjë. Për të shënuar 10-vjetorin e vdekjes së Márquez-it, Penguin Random House Britani e Madhe do të ribotojë 16 tituj nga lista e librave të tij gjatë vitit 2024, duke filluar me gjashtë tituj në datën 1 shkurt: *Njëqind vjet vetmi*; *Dashuri në kohën e kolerës*; *Kolonelit s'ka kusht ti shkruaj*; *Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar*; *Për*


*dashurinë dhe demonë të tjerë*; dhe *Përmbledhje tregimesh*.

### Hijet e shumta të dashurisë

Sipas një njoftimi nga Viking, fillimisht, Rodrigo dhe Gonzalo García Barcha respektuan dëshirat e babait dhe dorëshkrimi u mbyll me letrat e tij të tjera në një arkiv në Universitetin e Teksasit. Sidoqoftë, dyshja më vonë “rishqyrtoi cilësitë e jashtëzakonshme të librit dhe sa nga gjenialiteti, ngjyra dhe dashuria e babait të tyre jetonin brenda fjalëve të tij”. Botuesi shtoi: “Pas një diskutimi të gjatë ata morën vendimin që romani më në fund të ndahej me miliona lexues të përkushtuar në mbarë botën”.

Rodrigo dhe Gonzalo García Barcha thanë: *Shihemi në gusht* ishte fryt i përpjekjes së mbrame të babait tonë për të vazhduar të krijojë pavarësisht gjithçkaje. Duke e lexuar edhe një herë gati 10 vjet pas vdekjes së tij, zbuluam se teksti kishte shumë merita që vërtetë të japin kënaqësi dhe asgjë që na pengon të shijojmë dhe kënaqemi me aspektet më të spikatura të veprës së Gabos: aftësinë për të trilluar, gjuhën poetike, rrëfimin magjepsës, botëkuptimin e tij për njerëzimin dhe dhembshurinë për përvojat dhe fatkeqësitë tona, veçanërisht për dashurinë, ndoshta tema kryesore e gjithë veprës së tij”.

Kur Márquez-i i rilexoi librat e vet gjatë pleqërisë, për të kujtuar sadopak jetën dhe arritjet e tij, i duke sikur po i lexonte për herë të parë. “Nga drejtin kanë dalë këto?” - më pyeti një herë. Kështu, vijoi t'i lexonte veprat e tij deri në fund, duke arritur t'i dallonte si libra të njohur nga kapakët, por duke kuptuar shumë pak nga përmbajtja e tyre. Kishte raste kur, pasi e mbyllte një libër, habitej kur shihte fotografinë




e tij në kapakun e pasmë dhe e hapte përsëri, duke u orvatur ta lexonte nga e para,” shkruan Rodrigo García në “Lamtumirë Gabo dhe Mercedes: kujtimet e birit për Gabriel García Márquez dhe Mercedes Barcha” (2021).

Duke qëndruar në këmbët e shtratit të tij gjatë viteve të fundit të Marques-it, Rodrigo García do të vinte re se si truri i të atit, pavarësisht nga demenca (dhe ndoshta i ndihmuar nga morfina), vazhdonte të ishte “kudhra e krijimeve” të tij, siç kishte qenë përherë: “I copëzuar, mbase i paafte t’u kthehet mendimeve apo të ruajë linjën e historive, por gjithsesi aktiv. Imagjinata e tij kishte qenë përherë mrekullisht pjellore. Gjashtë brezat e familjes Buendía përbëjnë *Njëqind vjet vetmi* (1967), por ai kishte material të mjaftueshëm edhe për dy breza të tjerë”.

### Thelbi i vetmisë së tij

“Pavarësisht nga natyra e shoqërueshme dhe rehatia në dukje që i jepte jeta publike, Marquez-i ishte një njeri privat, ndonjëherë edhe i mbyllur. Me këtë nuk dua të them se nuk i pëlqente fama apo se pas dekadash të tëra lajkatimesh nuk ishte i prekur nga narcizmi, përherë dyshonte në të qenët i famshëm dhe në suksesin letrar. Përpara se të merrte çmimin Nobel në vitin 1982, ai do t’i kujtonte herë pas here familjes dhe vetes, se as Tolstoi, as Proust-i apo Borges-i nuk arritën të merrnin çmimin e lakmuar letrar, sikundër edhe tre shkrimtarët e tij të parapëlqyer: Virginia. Woolf, Juan Rulfo dhe Graham Greene. Shpesh i dukej se sukcesi nuk ishte diçka që e kishte arritur, por diçka që i kishte ndodhur”, shkruan Rodrigo García.

“Poetë dhe lypës, muzikantë dhe profetë, luftëtarë dhe mujsharë, të gjitha krijesat e atij realiteti të shfrenuar, lypnin vetëm pak imagjinatë, sepse problemi ynë vendimtar ka qenë mungesa e mjeteve konvencionale për ta bërë jetën tonë të besueshme. Në një ditë si kjo e sotmja, mjeshtri im William Faulkner tha: “Nuk e pranoj fundin e njeriut”. Ky, miqtë e mi, është thelbi i vetmisë sonë”, tha Marquez-i në fjalimin e pranimit të Nobelit. Në vitin 1949, në fjalimin e tij për pranimin e Nobelit, Faulkner-i nuk kishte pranuar fundin e njeriut. “Është e lehtë të thuash se njeriu është i pavdekshëm thjesht sepse do të durojë, se kur të jetë dëgjuar boria e fundit e botëmbarrimit dhe të jetë shuar shkundullima e shkëmbit të fundit në rrokullimë në atë mbrëmje të mbrame të përflakur



që fiket, edhe atëherë, do të dëgjohej ende një kumbim: ai i zërit të tij të mezindjeshëm, të pashtershëm, që ende flet”.

“Nuk e pranoj këtë. Besoj se njeriu jo vetëm do të durojë, por do të ngadhënjë. Është i pavdekshëm, jo sepse ndër të gjitha krijesat, vetëm


zëri i tij është i pashtershëm, por sepse ka frymë, shpirt të aftë për dhembshuri, sakrificë dhe durim. Detyra e poetit, e shkrimtarit, është të shkruajë për to. Është e drejta e tij e veçantë ta ndihmojë njeriun të durojë duke ia çuar zemrën peshë, duke i kujtuar guximin, nderin, shpresën,

krenarinë, dhembshurinë, mëshirën dhe sakrificën, të cilat kanë qenë lavdia e së shkuarës së tij. Zëri i poetit nuk duhet të jetë thjesht dëshmi e njeriut, sepse mundet me qenë gur themeli, kolonë kua ai mbështetet që të durojë dhe të ngadhënjë”, kishte theksuar Faulkner-i.

Deri vonë në jetë, ndërsa kujtesa e Marquezit po venitej, ai kurrë nuk i rilexonte librat e vet (ndonëse shumë më vonë në jetë, kur kujtesa po e linte, filloi t’i lexonte), nga frika se mos gjente të meta që do t’a bënin t’i vinte turp dhe se mos ia shternin krijimtarinë. Pavarësisht nga mohimi këmbëngulës se në shkrimet e tij nuk ka asgjë qëllimisht simbolike në shkrimet e tij dhe pavarësisht nga përbuzja që tregon për të gjitha teoritë akademike apo intelektuale që mund të hedhin dritë mbi ndonjë imazh në rrëfimet e tij, e dinte se, ai ishte skllav i pavetëdijes. Ai e dinte se disa gjëra janë aty si zëvendësuese të gjërave të tjera. Si shumë shkrimtarë, edhe ai ishte i fiksuar pas humbjes dhe vdekjes, shfaqjes më të madhe të saj. Vdekja si rregullsi dhe parregullsi, si e logjikshme dhe e pakuptimtë, si e pashmangshme dhe e papranueshme”.

Rodrigo García kujton vuajtjen tepër të madhe kur shihte të atin në një gjendje të atillë ankthi, duke i përsëritur vazhdimisht vetes gjatë fazës së hershme të demencës: “Unë me kujtesën punoj. Kujtesa është instrumenti dhe lënda ime e parë. Nuk mund të punoj dot pa të. Më ndihmoni”. Kur më në fund rifitonte njëfarë qetësie, ndonjëherë thoshte: “Po më lë kujtesa, por, fatmirësisht, harroj se po më lë”.

Përktheu: Granit Zela



### Na flisni fillimisht pak për letërsinë shqiptare!

Është një letërsi që nis të shkruhet në Mesjetë, në fillim në latinisht si të gjitha letërsitë europiane të kohës dhe, në vazhdim, njëkohësisht me këto letërsi, vjen edhe shkrimi i librave në shqip. Por, për shkak të pushtimit të vendit nga Perandoria Osmane, ku shqipja ishte e ndaluar si gjuhë kulture, autorët jetojnë, shkruajnë dhe botojnë kryesisht jashtë territoreve shqiptare. Pavarësisht nga distanca, veprat e tyre mbeten thellësisht shqiptare sepse subjektet që trajtojnë janë thelbësisht shqiptare.

Duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit XIX letërsia shqipe merr një zhvillim të madh. Shkrimtarët dhe poetët janë në pararojë të lëvizjes kombëtare për çlirim nga pushtimi osman dhe themelimin e një shteti të pavarur shqiptar. Rrjedhimisht edhe letërsia e tyre pasqyron me një fuqi të lartë artistike këto aspirata.

Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1912 letërsia shqipe merr më në fund frymë lirisht dhe nis t'iu bashkohet shkollave letrare europiane duke e zgjeruar horizontin e vet tematik, por duke qëndruar e lidhur fort me identitetin kulturor dhe kombëtar shqiptar si dhe me historinë politike të vendit. Madje, pikërisht historia politike e vendit do ta përcaktonte në një masë dramatike zhvillimin e kësaj letërsie. E kam fjalën për periudhën e sundimit komunist (1945 - 1990).

Gjithsesi, bëhet fjalë për një letërsi të shkruar në një gjuhë të vogël e shumë pak të njohur jashtë territoreve ku jetojnë shqiptarët, e cila megjithatë është shumë e pasur si në poezi edhe në prozë dhe që vazhdon të zhvillohet me një dinamikë të mirë.

### A e ka kapërcyer sot Shqipëria izolimin ku e pati futur komunizmi?

Përgjigja më e shkurtër është "ende jo". Komunizmi sundoi në Shqipëri si një diktaturë mizore, duke i përdorur deri në ekstrem si represionin policor edhe represionin kulturor. Për pasojë e damkosi rëndë mentalitetin e njeriut shqiptar. Janë lindur e janë rritur tre apo katër breza nën këtë represion të dyfishtë, pa patur asnjë referencë tjetër politike apo kulturore. Për të mos u zgjatur me përshkrime, po ju tregoj një video që pashë para disa ditësh në rrjetet sociale.

Ishte filmuar një arushë me emrin "Ina", diku në Rumania. Kjo arushë e shkretë kishte kaluar 20 vjet e mbyllur në kopshtin zoologjik. Para 7 vjetësh aktivistët për të drejtat e kafshëve e kishin çliruar dhe dërguar në pyll. Edhe pse në mes të pyllit, e lirë tashmë, arusha Ina vazhdonte prej 7 vjetësh të sillej rrotull si e tërbuar në një sipërfaqe prej disa metrash katror, si dikur brenda kafazit. Ajo nuk dinte të vraponte drejt, nuk e kuptonte hapësirën e lirë, nuk e njohte horizontin e largët. Kështu është në njëfarë mënyre ende sot shoqëria

Intervistë botuar në suplementin kulturor të gazetës më të madhe saudite « Okaz » më 17 shkurt 2024

# BESNIK MUSTAJAJ: POLITIKAN QË SHKRUANTE ROMANE APO SHKRIMTAR QË MERREJ ME POLITIKË?

Bisedoi: Ali Fajim

shqiptare, si ajo arusha rumune, e cila sillet rreth vetes, e paaftë për ta gëzuar lirinë.

### Po hapja kaotike që pasoi izolimin a është kapërcyer?

Hapja e Shqipërisë ka hyrë në një fazë shumë të përparuar dhe nuk mund të jetë më kaotike siç ishte në vitet e para të rrëzimit të diktaturës. Vendi ynë është tashmë anëtar i Këshillit të Europës, anëtar i NATO-s dhe

kandidat për në Bashkimin Europian. Kjo do të thotë se klasa politike ashtu si edhe administrata publike kanë mësuar rregullat e negociimit me partnerët tanë në botën, drejt të cilës po hapemi. Po ashtu edhe qytetarët, kanë mësuar se, për të shkuar në vendet e tjera, nuk ka rrugë tjetër veç asaj të zbatimit të disa rregullave dhe ligjeve, të cilat nuk janë vendosur në Tiranë, por në kryeqytetet e tjera.

Më kryesorja është se ka ndryshuar rrënjësisht qasja e njeriut shqiptar

ndaj pjesës tjetër të botës. Në kohën e izolimit, kjo pjesë tjetër e botës paraqitej në sytë e popullit si armike. Tani shihet si mike. Dhe me mikun nuk bashkohesh duke shkuar drejt tij në mënyrë kaotike e të rrëmujshe, por me mirëkuptim e duke zbatuar rregullat e ligjet. Shqetësim i madh sot mbetet përhapja epidemike ndër shqiptarët e prirjes për të emigruar. Kjo do të thotë se janë ftohur pak lidhjet shpirtërore të shqiptarëve me atdheun e tyre. Po vazhdoi kështu, vendi do të boshatiset nga forcat vitale, duke rrezikuar të shndërrohet në një azil gjigand pleqsh.

### Çfarë mesazhesh përpiqeni ju si politikan dhe si shkrimtar të theksoni përmes veprës tuaj letrare?

Si njeri politik gjatë njëzet vjetëve jam përpjekur të përcjell mesazhin se demokracia, ashtu siç thoshte Uinston Çerçill, është një sistem i keq, por shoqëria njerëzore nuk ka shpikur ende një sistem më të mirë për lulëzimin e personalitetit të njeriut. Por, ndërtimi i demokracisë është një proces, i cili nuk kryhet me urdhëra nga lart. Në të duhet të marrin pjesë të gjithë qytetarët, në përditshmëri, me ndërgjegje të çliruar politike dhe me durim të madh.

Vepra ime letrare përfshin poezi, tregime, romane, ese dhe novela. Janë afro pesëdhjet vjet krijimtari. Të gjitha shkrimet e mia letrare i bashkon përpjekja ime për të treguar marrëdhënien dramatike që ka patur gjithmonë e veçanërisht në kohët moderne njeriu shqiptar si individ me Historinë kolektive, e cila është përcaktuar gjithmonë në shtatmadhoritë politike të radhës. Njeriu shqiptar si individ vetëm e ka pësuar këtë Histori, i pafuqishëm për ta zgjedhur në një mënyrë a në një tjetër fatin e vet.

### Çfarë ju ka dhënë puna në politikë dhe çfarë ju ka marrë?

Përvoja në politikë më ka dhënë mundësinë ta vëzhgoj nga brenda si funksionon makineria e pushtetit politik dhe ta vërej drejtpërdrejtë sa e pamëshirshme është ajo. Rrjedhimisht, kam kuptuar më mirë përse njeriu si individ duket aq i vogël dhe i dobët përballë kësaj makinerie. Në këtë kuptim, përvoja në politikën e niveleve të larta më ka shërbyer dhe vazhdon të më shërbejë ndjeshëm për ta bërë më të vërtetë e më realiste letërsinë që shkruaj.

Nga ana tjetër, përfshirja në politikë më ka marrë gjatë afro dy dekadave gjënë më të rëndësishme për një shkrimtar e që është koha për të shkruar. Fatkeqësisht, këtë kohë të shkrimit e kam humbur dhe nuk do të mund ta fitoj më kurrë. Unë nuk kam qenë një politikan që shkruante romane. Kam qenë një shkrimtar që merrej me politikë. Kjo vetëdije për prioritetin që kishte shkrimtari

The image shows the cover of a book titled "BESNIK MUSTAJAJ: POLITIKAN QË SHKRUANTE ROMANE APO SHKRIMTAR QË MERREJ ME POLITIKË?". The cover is primarily white with green and black accents. At the top left, there is a green box with the number "12". To the right of this is the logo for "عكاظ الثقافة" (Okaz Culture) and the date "الجمعة - السبت 07-08 شباط 2024" (Friday - Saturday, February 7-8, 2024). Below the logo, there is a subtitle in Arabic: "قال إن معرفته بالأدب السعودي محدودة" (He said his knowledge of Saudi literature is limited). The main title is written in large, bold, black Arabic calligraphy: "بسنيك مصطفى: الأدب الألباني مكتوبٌ بلغة صغيرة وغير معروفة!". Below the title is a portrait of the author, Besnik Mustajaj, wearing a dark jacket and a light-colored scarf. To the right of the portrait is a small circular icon with the author's name "حاوره: علي فاجيم" (Interviewed by: Ali Fajim) and a social media handle "@alm33e". Below the portrait, there is a list of topics in Arabic: "● حياتي: من أين أتيت؟ ● من أين أتيت؟ ● من أين أتيت؟ ● من أين أتيت؟ ● من أين أتيت؟". At the bottom of the cover, there is a list of topics in Albanian: "● لغتي الأم غير محدودة ● لغتي الأم غير محدودة ● لغتي الأم غير محدودة".




Biblioteka "Zoja e Shkodrës" pranë famullisë me të njëjtin emër ka vendosur që katin e dytë t'ia kushtojë bibliografit, studiuesit, përkthyesit dhe diplomatit Willy Kamsi, si peng nderimi e shenjë kujtese për një figurë të shquar me kontribut të shtrirë në disa fusha të shoqërisë. Në këtë rast, kjo bibliotekë e vogël shlyen një borxh që e ka e gjithë shoqëria ndaj një personaliteti që me punë e mundim e mbrojti qytetin atëherë kur e shkuara e tij synohej të zhbëhej e në këtë mënyrë, e ardhmja të ishte e njëtrajtshme me të çdo qyteti të ri plot me njerëz të rinj në një sistem të ri, por në vetvete aq të vjetër sa vetë mizoria.

Ky akt i vogël dhe domethënës më shtyu edhe mua ta përkujtoja në "ExLibris" bibliofilin erudit, njeriun që gjithë jetën e përkushtoi në mbrojtjen dhe promovimin e idealeve ku besonte, të përmbledhura më së miri në binomin që jeta e tij huazoi nga françeskanët, *fe e atdhe* duke i shtuar edhe një tjetër përmasë, *kulturë*. Një përkujtim pak më i veçantë, nëpërmjet dikujt tjetër, një gruajë e cila përmendet shumë pak, Miryam Kamsi, ose Mila, kaq, thjeshtë Mila.

Unë nuk e kam njohur personalisht Willyn. Atëherë kur krijova interesin tim për filologjinë, ai kishte ndërruar jetë. Por motra e tij, Mila jetonte akoma, në shtëpinë që ndau gjatë gjithë jetës me të vëllanë. Sepse të dy qenë të pamartuar, bashkudhëtarë të njëri-tjetrit përgjithnjë. Isha tetëmbëdhjetë vjeç dhe punoja në portalin [konica.al](http://konica.al). Mila, pasi e telefonova në telefonin e shtëpisë, më priti dhe më tregoi, aq sa mundi e ashtu si mundi, mijëra libra të vendosur në çdo skaj të shtëpisë dhe pjesën e dytë, kuti plot me libra të futura në *jerevi*. Amaneti i Willyt ishte që librat e tij dhe të familjes t'i bashkoheshin koleksioneve të bibliotekës "Atë Gjergj Fishta" në Shkodër, bashkë me objektet personale. Dhe kjo ndodhi, jo shumë kohë më vonë, në një ceremoni të posaçme pranë teatrit "Illyricum" të fretëve minorë.

Mila më tha shumëçka, e ndër të tjetra, më dhuroi edhe njëren prej bibliografive të përgatitura nga Willy me këtë dedikim:



Po si ka mundësi që kishin aq shumë libra? Aty u njoha për herë të parë me historinë e familjes, lidhjen stërgjyshore me Engjëllorët e Drishtit dhe miqësinë e atit të tyre, Gjonit, vëllai i folkloristit, leksikografit dhe arsimdashësit Kolë, me Luigj Gurakuqin. Në vazhdim, do të përpiqem të bëj një përvojim historik të familjes nëpërmjet fjalëve të Milës, duke ruajtur të drejtën për një dozë të lehtë subjektiviteti. Hapësira për secilën figurë dhe ngjarje të kësaj familjeje mund të mos jetë proporcionale me rëndësinë që mbart, por patjetër, është e njëjtë me peshën e emocionit që shoqëronte Milën teksa m'i rrëfente.

*Nga familja Kamsi kam njohur vetëm Miryam, ose Milën sikundër më kërkoi ta thërrisja. Nëpërmjet emocioneve të saj teksa më rrëfente historinë e familjes, shkrova këtë përkujtim për Willy Kamsin, më së pari dhe gjithë brezin e fundit të dinastisë së tij, pasardhëse e Engjëllorëve të Drishtit*

## NJË PËRVIJIM HISTORIK I FAMILJES KAMSI NËPËRMJET EMOCIONEVE TË MIRYAM

nga Andreas Dushi

### WILLY

Lindi në Bari me 17 dhjetor të vitit 1926. Në vendlindje ndoqi shkollën fillore e të mesme, në institutin *Di Cagno Abbrescia* që drejtohej prej etërve jezuitë. Më '43, u kthye në atdhe dhe akoma student, nën drejtimin e Filip Fishtës, filloi të parin angazhim me karakter bibliofil si punonjës me kohë të pjesshme në Bibliotekën e Institutit të Studimeve Shqiptare në Tiranë. Më '48 përfundon edhe maturën në Gjymnazin e Tiranës.

Komunizmi sikurse gjithë familjet shkodrane që jetonin në Tiranë, i dëbon nga kryeqyteti dhe për fat të mirë, familjen Kamsi e kthen në Shkodër aty nga viti 1953. Nuk i ndahet dot bibliotekës, ndaj sapo kthehet, kërkon dhe fillon punë vullnetarisht pranë bibliotekës së qytetit. Pasi arrin të punësohet në zyrën teknike të Bashkisë Shkodër, kontributi dhe rëndësia e tij bëhet e njohur, kështu më 1963 emërohet si përgjegjës i Bibliotekës së Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, sot Biblioteka e Universitetit Luigj Gurakuqi. Punon aty për njëzeteshtatë vjet dhe dymbëdhjetëfishon koleksionet, nga dhjetë mijë njësi në njëqindënjëzet mijë sosh duke hedhur themelet e një fondi albano-balkanologjik ndër më të mirët në Shqipëri pas atij të Bibliotekës Kombëtare. Që politika e tij në drejtimin e institucionit që jo vetëm pasuroi fondet e bibliotekës, por ruajti edhe disa nga librat më me vlerë të familjeve të vjetra shkodrane. Bëhet fjalë për libra që nuk i mbanin dot në shtëpi pasi regjimi i kishte kthyer në të ndaluar, kështu Willy u ofrua t'ua blinte dhe ia doli të ruante edhe librat nga regjimi, edhe familjet nga librat. Vetë Willy thotë në shënimet e veta biografike se *ishin libra të blemë kryesisht nga familje katolike të Shkodrës*. Rreziku i këtij vendimi sot mund të kuptohet me vështirësi e po ashtu, rëndësia e tij për kulturën e qytetit ndoshta ngjan pa ndonjë rëndësi të veçantë.



Willy Kamsi duke i dorëzuar letrat kredenciale Papa Gjon Palit II

Por është krejt e kundërta! E shkuara duhej zhdukur, pasi vetëm kështu njeriu i ri mund të krijohej i lirë. Gjetja e një mënyre për ta ruajtur këtë të shkuar dhe në të njëjtën kohë, ndihma e dhënë për ata që më së paku përkraheshin nga shteti, klasa intelektuale e para '44 pasi ajo zotëronte bibliotekat më të mëdha, është një ndër veprimet më gjeniale që dikush mund të ketë bërë atëbotë.

Shërbeu në atë detyrë deri më 1990, për t'u emëruar mandej, një vit më vonë si Ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Vatikan. Willy Kamsi është i pari ambasador i Shqipërisë në Vatikan, pasi deri më atëherë nuk kishin ekzistuar marrëdhënie diplomatike mes shtetit Shqiptar dhe Selisë së Shenjtë. Letrat Kredenciale i dorëzoi para Papa Gjon Palit II (tani shën Gjon Pali II) më datë 22 prill 1993, pak ditë para vizitës së Tij në Shqipëri. E ushtroi këtë funksion deri më 1996.

Kthehet në Shkodër dhe jep një ndihmesë të jashtëzakonshme në ngritjen e bibliotekës së Institutit Teologjik dhe Filozofik "Zoja e Këshillit të Mirë", seminari ku formohen meshtarët e të gjitha dioqezave shqiptare. Ja del të ngrejë një bibliotekë të pasur teologjike por pa harruar edhe pasurimin e fondeve albano-balkanologjike. Falë punës dhe përkushtimit të tij, katalogjet e saj pasqyrojnë një pasuri të pasohet ndër biblioteka të institucioneve private. Me iniciativën e tij, biblioteka merr emrin "At Zef Valentini S.J.", kështu bëhet i pari institucion që mban emrin e albanologut tejet të rëndësishëm por pak ose aspak të përmendur.

Ndër të tjera, hartoi edhe katër bibliografi retrospektive kronologjike për periodikët kryesorë të para '44-ës: "Hylli i Dritës", "Albania", "L.E.K.A" dhe "Shejzat" e "Shkëndija" në një vëllim të vetëm.

Pasi Mila m'i tregoi këto, u ngrit dhe kërkoi në morinë e paimagjineshme të librave. Ishin disa revista të lëna bashkë



horizontalisht mbi disa libra me lartësi të ndryshme. "Këtu ashtë Vili," më thotë. Mendova mos ishin foto të tij, por jo, bëhej fjalë për artikuj të ndryshëm me karakter gjuhësor, arkeologjik apo historik, si dhe të një fushe ku nuk e njihja kontributin e Willyt, studimin e monumenteve.

Mandej, tek po kërkonte një kumtesë të vëllait mbajtur në *L'Orientale* në vitin 2005 me temë *Thirrja e krishterë dhe europiane e Gjergj Kastriotit Skanderbegut*, gjeti disa kartolina dhe m'i solli.

"A e di çfarë janë?" më pyeti.

"Kartolina," i them.

"Po," - tha dhe mori të fundit. Ishte bardh e zi, dukej shumë e vjetër. "Vit për vit, të gjithë sa ishim në shti shkrunim një kartolinë të përbashkët për Kshnella. Shihe, ktu janë baba, nana, Vili edhe unë. Te tana këto jena te katërt. Ndërsa te këto, ne të tre, pa baben. Te këto të tjerat, me ma shumë ngjyra se janë mbas '90-ës, jam vetëm me Vilin. Ndërsa tesh, i bjen ta shkruaj vetem, për vedin, po çka mund t'i uroj vedit tem?"

Prej asaj dite, mbetem jashtëzakonisht shumë kureshtar t'i lexoj ato kartolina. Jo nga përmbajtja, por nga emocion. Vetëm ideja se janë më mbush me një përjetim të panjohur, diçka mes trishtimit tek sheh si firojnë emrat e anëtarëve të familjes dhe gëzimit për një kujtim kaq të bukur që është bashkëndarë mes tyre. Nuk e di si po vijon, madje as nëse ka filluar apo ka mbaruar puna me katalogimin e bibliotekës, arkivit dhe sendeve personale të familjes Kamsi në bibliotekën e françeskanëve, është shumë e vështirë të marrësh ndonjë informacion aty. Sidoqoftë, ky rrëfim i Milës më vjen shpesh në mendje dhe falë tij e kuptoj se jeta e saj ka qenë një jetë e kaluar në plotni, paçka se përkushtimi deri në vetëmohim për t'i shërbyer të atit e të vëllait bashkë me zgjedhjen për të qëndruar përherë në hije krijonjë një ide krejt të kundërt nga kjo e vërtetë madhështore.

Willy vdiq më 24 janar, 2017 në shtëpinë e tij në Shkodër. Ndërsa Mila, më 21 nëntor, 2021 në shtëpinë e kujdesit të motrave të Nënë Terezës në Tiranë.

### KOLË KAMSI

*në shënimet e të vëllait, treguar prej mbesës së tij*

Lindi në Shkodër më 24 shtator, 1886. Shkollën e ndoqi në Shën Dhimitër Koronë, kolegji italo-arbëresh ku njohu shumë mirë edhe dialektin e arbëreshëve. Kthehet në Shqipëri, mbaron *Normalen* e Elbasanit dhe emërohet mësues në filloren italiane të Vlorës. Jemi në vitin 1907. Është po ai vit kur boton dy artikujt e parë në "Albania", me pseudonimin *Komneni*.

Ndaloi këtu për të parë bibliografinë e nipit të tij për "Albanian" dhe gjej pa vështirësi artikujt e përmendur. I pari titullohet "Do karaktere të veçanta të dijetarëve". Kërkoj "Albanian" dhe shkoj



Kolë Kamsi



Gjon Kamsi



Willy dhe Miryam Kamsi

aty ku më orienton bibliografia. Në shkrim përshkruhen tiparet karakteriale të disa personaliteteve shumë të njohura nga çdo fushë e kulturës si Rossini, Njutoni, Volteri, Petrarka, Franklin, Shopen, Vagner, Monteskje etj. *Unë në jetëshkroje t'shkrimitarëve*, thotë në tekst, kam gejtë shumë ksi karakteresh t'çuditshme dhe ato i tregon me një dozë të lehtë humori, me shumë gjasë të paqëllimtë.

Shkrimi tjetër është për Graziadio Isaia Ascoli, si përkujtim pasi kishte ndërruar jetë një vit më herët në moshën 78 vjeçare. Ai ishte historian dhe një ndër gjuhëtarët e parë italianë, sipas Kamsit.

Nga figurat ndërkombëtare, pesë vjet më vonë do të orientohej të figurat me kontribut në dhe për Shqipërinë. Më 1912 shkruan për Edith Durham në "Kalendari Kombiar" që botohej në Sofie. Ndër të tjera, në shkrimin e titulluar "Një zemër bujare" thotë: *Me ndihmë të saj, lëvizja jonë muer një sulm të madh, fitoi një emen e një famë të naltë përpara kombeve t'Evropës e të Botës [së] Re, e si popull i Anglisë qi veçan e përkrahu ma tepër kombin tonë me anë të shtypit e me ndihma [të] tjera.... Si shihet, Shqiptarët sot për sot janë zemra e sajë.* Po aty, një vit më vonë shkruan edhe për Françesk Santorin.

Si njohës shumë i mirë i arbërishtes, arrin të paraqesë në kompleksitetin e tyre edhe shkrimtarë të tjerë arbëresh, ku vend shumë të rëndësishëm zë de Rada. Gjithsesi, përtej aktivitetit të përhershëm në shtypin e kohës, jep një ndihmesë të jashtëzakonshme në themelet e arsimit shqiptar, duke hartuar e botuar shkrime të ndryshme me karakter didaktik, si për shembull "T'i mësojmë fëmijët me folë", "Historija", "Gjeografija", "Rendi qi duhet në mësimin e gjeografisë", "Ortografija", "Edukimi e morali" etj., të gjitha të botuara në organin e Ministrisë së Arsimit "Shkolla e re" në vitin 1920.

Është një nga të parët që bën edhe

përshkrime antropologjike të jetës arbëreshe, veçanërisht në "Kalendarin" e Veprës Pijore të vitin 1927. Vite më vonë, në "L.E.K.A" fillon të botojë monografinë "Shqiptarët e Italisë", nga '34-'44. Por kjo punë dhjetëvjeçare nuk e shkëputi nga angazhimet në fusha të tjera. Më '34 boton një recesion për veprën e atë Justin Rrutës "Letratyra Shqype" bashkë me artikullin shumë të rëndësishëm "Nji letër e Abdyl Frashërit Françesk Krispit".

Me rastin e njëzetepesë vjetorit të pavarësisë, më 1937 mblodhi nga të gjitha gazetatat shqipe brenda e jashtë vendit shkrime me karakter historik dhe kombëtar për t'i botuar po atë vit, sërish te "L.E.K.A".

Për herë të parë boton një vepër të panjohur të Santorit me titull "Nji dorëshkrim i panjoftun i At Anton Santorit - Prralla të zgjedhuna" në vitin 1943, vit kur mblodhi po ashtu të gjitha proverbat e botuara deri më t'atëherë te "L.E.K.A".

Në revistën "Agimi" krijoi rubrikën "Exlibris" ku botonte herë pas here shprehje nga autorë të ndryshëm për fusha të llojllojshme, nga historia te letërsia, filozofia, shoqëria etj.

U mor gjatë me shkrime historike, përkthime e studime, të orientuara kryesisht nga arbëreshët, çka u përmblodhën më së fundmi në *Fjalori i Dialektit Arbëresh*, botuar shumë vonë, aty nga fillimi i viteve 2000 falë Willyt.

Profesor Jup Kastrati tregon se *një ditë para se të vdiste ai i dorëzoi në shtrat, në shtëpinë e vet në Shkodër, profesor Mahir Domit veprën e tij jetësore dhe më të mirën e krijimtarisë së tij shkencore: "Fjalorin e dialektit arbëresh" me 23 shkurt, 1960. I tha këto fjalë: Po vdes i qetë. Zotimin e marrë para Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë e mbajta."*<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Kastrati, Jup, "Kolë Kamsi, Punëtor i palodhur në lëmin e arsimit e kulturës kombëtare", "Shkenca dhe Jeta", nr. 1, fë. 127, 1991.

Në vitin 2005, Këshilli Bashkiak i Shkodrës vendosi të krijojë me emrin Kolë Kamsi një titull nderimi për profesionin e mësuesit.

### GJON KAMSI

Lindi më 20 prill, 1894. Qe mik i afërt me Luigj Gurakuqin dhe përgatitësi për botim i poezive të tij, shoqëruar me jetëshkrimin që përgatiti po vetë. Ndodhej në të njëjtin qytet me Luigjin kur shtjenë mbi trupin e tij, i shkoi pranë dhe i mori këmbishën e gjakosur për ta sjellë në Shqipëri. Me këtë vepër e çoi në një përmasë tjetër historinë e patriotit të vrarë pabesisht.

Ishte miku i mirë i personaliteteve më të rëndësishme të kohës si atë Gjergj Fishta, atë Pal Dodaj e të tjerë. Mila më tregoi edhe dy stilografë, tanimë pjesë e bibliotekës françeskane, që vetë Fishta ia kishte dhuruar asaj e të vëllait në vegjëli.

Për të atin, Mila kishte atë soj adhurimi sa ta ruante edhe prej fjalëve të saj.

"Ai e zhvilloi aktivitetin e tij në Bari të Italis", më thotë. "Ishte bashkëpunëtor i shtypit kombëtar brenda dhe jashtë vendit dhe anëtar i [lidhjes së] gazetarëve të huaj në Itali. Ka botue në revistat e njohura të asaj kohe: "Posta e Shqypnisë" dhe "Bashkimi i Kombit". Gjithashtu ka bashkëpunuar edhe me shumë gazeta e revista të tjera, ku ndër to dallohet bashkëpunimi pesëvjeçar me "Hylli i Dritës".

Edhe shkrimet e tij janë me karakter antropologjik si dhe, ndryshe nga pjesa tjetër e familjes, ka një vetëdije ekonomike dhe tregtare që më vonë do t'i vihej në dobi krijimit të institucioneve financiare të shtetit shqiptar. Në 1935 boton te "Hylli i Dritës" shkrimin: "Kriza dhe tregtija e jashtme e Shqipnisë" e po atë vit, kohë kur bashkë me familjen ishte akoma në Bari, "Shqipnija ndër marrëdhënie tregtare me Italí, Greqí dhe Jugosllaví".

Edhe vitin pasardhës, vijon me shkrime të kësaj natyre si "Ngjarje anasjellse n'ekonomín kombtare të Shqipnisë" apo "Rrugë të reja në politikën tregtare të Shqipnisë". Madje në tre numra rresht, të nëntorit dhe të dhjetorit të '36 si dhe të shkurtit '37, bën edhe një analizë programit të kryeministrit për ekonominë.

Pa u ndarë asnjëherë nga shkrimet e këtij karakteri, boton edhe një përkujtimore për Gurakuqin me titull "Nji «28 Nanduer» gjaku (1926)" në dhjetor të 1939 si dhe përgatit për botim "Pavarsija e Shqipërisë" të Gurakuqit në '43, shkrim i cili sipas të birit *qe nxjerrë prej dorëshkrimevet të lanuna nga L. Gurakuqi [Gjon Kamsit dhe plaçkitë prej Sigurimit komunist në vjetin 1967].*

Fritz Radovani ka lënë një dëshmi shumë të bukur se si Gjoni, pas një festivali të Gjirokastrës çon një letër pranë Institutit të Etnografisë ku sqaron se gruaja shkodrane, në fakt nuk ishte paraqitur me dinjitet pasi i qe përcudnuar veshja. Mund të gjendet edhe në internet kjo letër, bashkë me përgjigjen e marrë.

I mbylli sytë më 7 mars, 1992, si dëshmitar dhe dëshmues i të gjitha epokave historike të formimit të shtetit shqiptar.

### DHE MILA

Për të nuk di asgjë. Dhe më vjen shumë keq për këtë. Nuk e pyeta as kur lindi, as për fëmijërinë, as për pasionet, ëndrrat, dëshirat, ndoshta ngase i shihja të gjitha të jetuara tekta më tregonte jetën e familjes, historinë nga ajo e Engjëllorëve të largët, te Kamsit e mesjetës që dalin në Zara e deri te të djeshmit, i ati, i ungji dhe i vëllai. Të paktën, Mila ishte ura që më njohu më konkretisht me to dhe falë bisedës me të, ky shkrim aq modest sa përvujtnia e saj botohet, edhe si shpagim i një detyrimi të brendshëm për figurat e mbetura padrejtësisht në plan të dytë të historisë.



Pjesë e bibliotekës dhe arkivit të familjes Kamsi, dhuruar bibliotekës së françeskanëve





krenarinë e tyre, edhe prej ati, teksa flet me vajzat apo djemtë e tij në Paris, Londër, Berlin, Vjenë, Romë, Madrid, New York, Tokio... Ai i adhuron fëmijët, vetëm një shqetësim ka, të rrisë pasurinë e tyre duke e administruar mirë paratë e popullit, me rreptësinë e një ekonomisti besnik, paratë që fiton me djersë balli në teatër e gjetiu., edhe në librari. Fjala e nxë edhe librarinë. Urtë e butë.

Kur kujtohet se dikur ky librar, dirigjent orkestre në një nga ato që tridhjetë vite më parë i gjeje ku të mundje, ku edhe këndohej, ata qenë dashuruar marrëzisht. Sot, ata janë miq të mirë. S'kanë kohë për t'u parë, as të bien dakord mes tyre se kush punon më shumë në librari, ndërsa mund të gjeje diçka tjetër më të mirë, ku të shprehësh gjithë talentin dhe bukurinë e saj, kurse ai, ta harronte atë violinë, që të kujdesej më mirë për sukseset e shoqërisë duke shitur libra!... Nuk mund të gjendet një familje më e bashkuar dhe më e ngrohtë, sesa burrë e grua artistë në një librari që mezi i nxë dy vetë, e mbushur deng me libra!...

- Ëndërr me sy hapur është kjo? - pyet gazetari i ndrojtur.

- Jo, e ke gabim! Ke paguar gjë ndonjë lekë për të parë ëndërra? - u përgjigj administratori i një shtëpie botuese. - Oh! Por menaxheri im është tepër i shkathët! I gjen sponsorët me nuhatje...

Pastaj ai bën shaka duke ngacmuar një nga koleget e shumta, duke e truar se po pastronte paratë e pista duke botuar libra! Mos, deri këtu paska arritur puna! Më pas hidhet dikush që thotë me një pamje të qetë se, sikur të ishte bërë botues, nuk do ta prishte pasurinë e tij kaq marrëzisht! Librat nuk shiten dhe shtëpitë botuese shtohen. Madje njëra prej tyre bën libra luksi! Duke folur, ai e vështronte 'bankierin' e tij sipër supeve të së shoqes, për të parë nëse ky ishte bërë bashkë me të, apo jo. Mirëpo, pas pak minutash, hidhet fjala tek ndërtuesit, të cilët bisedonin shumë pranë njëri-tjetrit, duke acaruar këdo që i shihte. Mos vallë po e humbte kohën kot me këto marrëzira? Dhe, me duart e bukura, ku dukej një diamant në gishtin e vogël, ai i jep fund një bisede të nisur për fëmijët, vazhdon akoma për librat dhe inteligjencën artificiale. Fjala, me ç'duket, duke qenë e mbushur me turbullira ngaqë ishte aq pranë me librin, kalon për inovacionin, të cilin ai ka pasur kënaqësinë ta shihte në Teatrin e Inteligjencës Artificiale. Kot, të betohem, nuk di se ç'pati edhe ai Edmond Tupja kur tha se shqipja nesër do jetë gjuhë e vdekur si greqishtja e vjetër dhe latinishtja. Epo nuk e di Tupja se do lindë shqipja e re, si greqishtja e re dikur (në kohën e librave!) ka për të qenë aq e mirë, por ajo ende ka për të qenë e mitur! Të pranishmit mbeten të çuditur kur mësojnë se shqipja jonë e re po i mbush ditët dhe ecën përpara, duke u bërë edhe më imponuese, madje!...

Libri ul qepallat e tij blu, edhe pse disi të shkulura, me qerpikë të djegur, pulit sytë, ndërkohë që flet e flet pareshtur për fatin e tij e të sivëllezërve. Në qoftë se, librat, në moshën e tyre serioze, nuk kanë ditur të vënë një dyshkë mënjanë, duke punuar gjithmonë me klientë të përsosur, për të kënaqur dëshirat e tyre, sidomos edhe me ata shumë të rinj, kjo do të thotë se vërtet edhe po të vdesë tani, ia paska vlejtur që ka jetuar kaq shumë...

Fundja, librat janë kaq të çuditshëm sidomos për moshën që kanë! Apo jo?...

Tiranë, më 27 shkurt 2024

Mbi librin "Apologji Marrëzive", të shkrimtarit Erjon Muça

## ÇMENDURIA POETIKE E EMPIRIZMIT EKZISTENCIAL

Nga Pol Milo

"Çmenduria, në një kuptim më të lartë, është fillimi i gjithë mençurisë."

- HERMAN HESSE

Apologji Marrëzive është libri i çuditshëm ku autori durrsak Erjon Muça, shkroi një sërë emblemash poetike, që i bluante në dorëshkrimet e tij prej kohësh. Dhe unë prej kohësh i kisha lexuar ato, duke u bërë kështu një pjesë e asaj loje, çmendurake apo artistike, siç do të donin të luanin poetët.

Për tu bërë pjesë e saj do duhej të përfshihej një tjetër artist durrsak, një piktor i fshehur në çmendurinë e tij metaforike dhe piktureske, që bredh rrugicave dimërore të lagura me shi, dhe hijeve të heshtura verore. Është pikërisht piktori i njerëzve të qytetit të tij, Ilir Berhami, që me penelat e pikturës në kopertinën e librit, e kapërcen këtë çmenduri, dhe e zhyt lexuesin në meditimin e tij empirik dhe ekzistencial. Piktura e tij shpreh më së miri fjalët e poetit që jeton në Itali, por që dërgon fjalë poetike përtej detit. Kurse deti bëhet urë valësh mbi shkumë vargjesh.

Në fjalët e thurrura me ngrohtësi të Erjon Muçës, zëri i poetit ngjall jehonë në thellësinë e ekzistencës sonë. Me marrëzitë e tij, ai hedh në ajër thënie që bien si shi në shpirtin tonë, duke na bërë të reflektojmë mbi çfarë do të thotë të jesh njeri në këtë botë kaotike.

Empirizimi i tij sjell në skenë një realitet alternativ, një fushatë poetike ku mendja nuk njuh kufij. Është çmenduria që shfaqet në fjalët e tij, ku secili varg është si një gur i hedhur në oqeanin e paqartësisë, duke shpërthyer rreze ndriçimi në çdo kënd.

Me kundërshtimet e tij të guximshme

ndaj konvencioneve, Erjon Muça bën thirrje për një liri krijuese, ku fjalët shkojnë përtej kufijve të zakonshme. Marrëzitë e tij janë si rrufe që shpërthejnë në qiell, duke ndezur një spektakël të pazakontë që sfidon mendjen tonë.

"Eh ky nocion, e mirë e keq  
sa do t'i lodhë njerëzit - ka të bëjë me fatin,  
me fitimtarin dhe humbësin..."

Dilema mes të mirës dhe të keqes dikur solli zhdukjen e dinozaurëve. Kjo "Apologji Marrëzive" nuk është thjesht një përshkrim i çmendurisë, por një udhëtim në thellësitë e vetëdijes, ku çdo fjalë krijon një univers të ri, një realitet paralel ku poezia bëhet çmenduri dhe çmenduria bëhet poezi.

Në këtë ekspeditë të fjalëve të marrëzisë, Erjon Muça shkon përtej kufijve të njohur dhe na udhëzon në një botë të pazakontë. Apologjia e tij është një fluskë që hedhim në oqeanin e ndjenjave, duke shpërthyer shkëmbime dhe dritë nëpër valët e panjohura të vetëdijes. Në këto dilema ekzistenciale, autori duket sikur hedh hipoteza imagjinatë të habitshme.

Për qytetin e tij të lindjes ai shkruan:

"O Durrësi im;  
si s'ke një një lumë që të kalojë në mes?  
Si shumë qytete të rëndësishme të botës!  
Po ty aq të bën  
përderisa të gjithë lumenjtë derdhen në  
det..."



Deti është një element i rëndësishëm për qytetin, dhe kjo shpreh mospërfilljen e ndikimit të tij në identitetin dhe ekzistencën e Durrësit. Ky fragment shpreh ndjenja të thella për qytetin, përvojën e tij historike dhe ndikimin e natyrës në zhvillimin e tij. Poeti përdor një gjuhë poetike për të shprehur ndjenjat e tij ndaj Durrësit dhe mjedisit të tij.

Fjala bëhet mjeti i shprehjes për të kuptuar thellësitë e një realiteti alternativ, ku logjika dhe normat humbasin kuptimin. Në këtë botë të re, çdo varg krijon një rrugë drejt një epifanie kaotike. Poezia e Erjon Muçës bëhet një manifest i lirisë krijuese, duke hedhur sfidë patetikes dhe duke shpallur një liri që çmendet me bukurinë e shpirtit krijues. Nëpërmjet çmendurisë poetike, ai na shpie në një udhëtim të çuditshëm, ku çdo fjalë krijon një univers të ri ku sundon paqartësia.

"Fantazmat e të ardhmes, edhe lugetërit,  
Janë të gjithë këtu, në një valle vorbulluese,  
Të çoroditur, pa e ditur  
Ndërsa ato të kalesës, edhe të së tashmes,  
Ka kohë që kanë ikur..."

Ky fragment poetik shpreh një ndjenjë të çuditshme ndaj kohës dhe perceptimit të saj në përjetësi. Fantazmat e të ardhmes dhe "lugetërit" përfaqësojnë aspiratat dhe ëndrrat për të ardhmen, të cilat ndodhen në një valle vorbulluese, duke sugjeruar një paparashikueshmëri dhe një ngatërrim të mundshëm.

Vargjet tregojnë një ndjenjë të humbëtrës, duke përdorur imazhin e kohës së ikur për të përshkruar të kaluarën dhe të tashmen që kanë lënë pas. Ndërsa fantazmat e të ardhmes janë ende "të çoroditura" dhe të paqarta, ato të kalesës dhe të tashmes kanë ikur. Përdorimi i imazheve të tillë poetike mund të përcjellë një sens të përjetshëm të kohës dhe një ndjenjë të çuditshme ndaj misterit të jetës.

Secili varg bëhet një stacion, duke na lejuar të ndjehemi si udhëtarë në një tren të ndaluar vetëm nga emocionet dhe mendimet. Fjalët bëhen një qytet i panjohur me rrugë kalimtare drejt ëndrrave, nëpërmjet urave lidhëse. Por këto ura shkojnë përtej të qëndrueshmes dhe reales:

"Ura, e gurtë, e mishtë,  
e qëndrueshme, e paqëndrueshme,  
reale, fiktive, pjellë e iluzionit të përjetësisë  
Ose pjellë e realitetit të vdekshëm.  
Ura personale e çdo krijese..."

Në këtë fragment poetik shprehet një reflektim mbi natyrën dhe simbolikën e urës, duke e trajtuar atë si një metaforë për jetën dhe përvojat e njeriut, që janë vetë këmbët e urës të ngulura gjallazi në empirizmin jetik.

Me ekzistencializmin e tij poetik, Erjon Muça bën që çdo detaj të jetë një aventurë, çdo tingull një udhëtim në një botë abstrakte. Duke eksploruar çdo hije dhe nuancë, ai na shton kuptimin që mund të nxjerrim nga çdo moment i ndërthurur në aftësinë e tij krijuese.

Poezia bëhet rrugëtim në kohë dhe hapësirë, dhe në këtë udhëtim të çuditshëm të fjalëve të Erjon Muçës, ne gjejmë një botë të re, një univers të ri që lind nga një revolucion jetësor.

"Në natyrë majmuni ndjek  
Fitimtarin e betejës...  
Vdekja është brenda nesh  
Pret vetëm çastin e revolucionit jetësor..."

Ky varg sugjeron një koncept të vdekjes si një pjesë e natyrshme e ekzistencës së njeriut. Në vend që të shihet si një ngjarje e huaj, vdekja pothuajse shpalolet si një realitet i brendshëm, një pjesë e qenies tonë që na shoqëron gjatë rrugës.

Nëpërmjet "Apologji marrëzive", ai shpall një manifest të lirisë të vërtetës krijuese.

Përtej fjalëve, çdo poezi e tij është një revolucion i vogël, një rebelim i bukur kundër zakoneve të prera. Ai na mëson se poezia nuk është vetëm një formë shprehjeje, por një liri që vjen nga shpirti dhe shkon drejt shpirtit të lexuesit.

Dyrrah, 2024



Njeriu është “homo sapiens” që do të thotë: *qenie inteligjente*. Por ndër ne lindin e jetojnë edhe “homo universalis” *qenie universale*, polimathë. Njerëz të tillë e kanë gjenezën nga një vendndodhje gjeografike por që kurrë nuk kanë një vendmbërritje, pasi janë qytetarë të botës, frymorë të jashtëzakonshëm të cilët mbajnë mbi supë barrën e epokave, përçojnë artin, dijen, fjalën dhe përvojën njerëzore, si të shkuar ashtu edhe të pandodhur, gardianë të portave hyrëse në terrina yshtjeje e dimensione të paperceptuara mendimi e krijimi. I tillë është Fate Velaj i cili me artin, penën dhe konceptet e tij tejkohore e mishëron më së sakti “homo universalis.”

Vdekatarët vlerësohen kryesisht për çfarë bëjnë e rrallëherë për çfarë janë. Fate bën dhe është. Ashtu si vetë fjala *Art*, që kuptimin më të saktë e ka nga gjermanishtja “kunst” që do të thotë *Plotësi*, edhe Fate Velaj është plotësi. Art që merr frymë e që shpaloset përmes pikturës, letërsisë, fotografisë dhe mjeteve krijuese që lidhin shtete, kultura, kontinentë, kohë dhe botë.

Kjo nuk është një ode për Faten por një impresion, një skicë e një tabloje të pangjyrosur, mbi triologjinë e tij *Kreuztanne*, e përbërë nga romanet: *Kreuztanne*, *Nilkon* dhe *Itaka*. Një triptikë fjalësh, një triologji pors i ditat, ku autori të fton për një shëtitje në një lokacion pa emër e pa kohë, e të tregon rrjedhën e jetës së tij, e cila çuditërisht e magjishëm duket se është edhe jeta jote, e madje jeta e të gjithëve.

Kjo triologji nis me akull e përmbillet me diell, por sakaq tregohet hollësisht një udhëtim i jashtëzakonshëm stinësh emocionale e përvojash njerëzore. Fillon me vitin 1991, me Faten emigrant i cili tregon: “*Ika më datë 19 korrik për në Pejë të Kosovës, te familja Tigani, për të bujtur tek ata atë natë e të nesërmen, me autobusin e kompanisë ‘Rusolia Tours’, me 100 marka gjermane në xhepin e pantallonave të cilat, që të dukeshin më i madh, i kisha veshur dy numra më të mëdhenj, u nisa për Austri.*” Atje, u caktua të banonte diku mes maleve të Sankt Antonit, te hoteli Gathaus Kreuztanne, duke nisur një jetë të re, e cila rezultoi gjarpëruese por drejt pedestalit, fillimi i një rrugëtimi që do e afirmonte atë si artist e kurator me ekspozita në Vjenë, New York, Bukuresht, Shkup, Kajro, Brimingham, etj, një ambasador fisnik i forcës përbashkuese që arti i bën kulturave, kombësive, kontinenteve, e madje edhe vetë kohës, siç ishte koncepti “Arti përmirëson kohën”, i realizuar në shkurtin e vitit 2002 në Vjenë e në maj të po atij viti, në Shkup, me synimin, ashtu siç shkruan ai te triologjia: “*si artist të jepja ndihmesën time në përmirësimin e kohës.*” Por duke mjekuar me kurën dhe balsamin e artit edhe vurrata reale kombësish përmes ekspozitës “Good morning Balkan” e cila “*Do të ndërtonte kështu një rrjet urash shpirtërore që do të lidhnin fort me njëri-tjetrin vendet e Ballkanit të cilët, pak vite më parë, ishin përfshirë nëpër luftëra absurde e kishin përgjakur përrenj e lumenj, fusha e male, fytyra fëmijësh e pleqsh, burrash e grash, duke lënë në hi e flakë shtëpitë e tyre ... Një thirrje për zgjimin e rajonit që për vite e vite me rradhë kishte qenë zhgëndrra e vetvetes.*”

Këto ura artistike, sikurse edhe ekspozita “Midis Danubit dhe Nilit”, nisma të cilat përmes penës ai i shpjegon se: “*ndërtojnë urat duke i lidhur me njëri-tjetër qimet e penelave të trazuara me ngjyrat e dala nga shpirti i tyre (artistëve nga vende të ndryshme të botës)*”, jo vetëm e zgjuan vëllazërinë njerëzore ndërkontinentale e universale, por e shtegtuan Fate Velajn në një skërkë të së ardhmes: “*Udhëtoja në të ardhmen time. Në vende të ndryshme, ku s’kisha qenë kurrë më parë e ku takoja njerëz që s’i kisha njohur kurrë më parë. Përjetoja situata të tjera, momente*

# FATE VELAJ, ARTISTI, SHKRIMTARI DHE NJERIU “UNIVERSALIS”

nga Dr. Bledar Kurti



pikturuar, ka sy për të fotografuar, ka gojë për t’u shprehur, etj. Por, e vërteta është që të gjitha krijimet burojnë nga shpirti i thellë, i plotë e i bukur. Pa qenien, asgjë nuk manifestohet. Pa qenien gjithçka është një mosgjë. Qenia e Fates është vigjilente për të manifestuar përmes fjalës dhe imazhit edhe kujtimet e së ardhmes.

Te pena e tij dallohet se ai është një vëzhgues i mprehtë i natyrës njerëzore. Personazhet përshkruhen në detajet më minimale. Është një antropolog i jetës së njerëzve të zakonshëm. Na mëson që çdo individ *per se* ka një histori për të treguar, se gjithësecili ka të orkestruar partiturën e jetës së vet, se çdo fytyrë është një portret që meriton të ekspozohet në galerinë universale të jetës dhe shoqërisë.

Fqinjët, kamarierët, takimet e rastësishme me të panjohur, përshkruhen me më shumë intensitet e ndjenjë se personalitete me grada dhe ofiqe te larta. Personazhet e tij janë të skulpturuara me fjalë. Ato na kujtojnë portretet e Franz Xaver Messerschmidt, skulptorit gjermano-austriak, i cili eksploroj gamën e emocioneve, personaliteteve dhe mimikave njerëzore. Atë që Messerschmidt e realizoi në vepra skulpturore, Fate e ka realizuar me letërsi, por madje duke e kapërcyer karakterin personal njerëzor, duke shpalosur mjeshtërisht përmes tyre perfaqësi kulturore e kombësie, siç i gjejmë te boshnjaku, turku, egjiptiani, serbi, rumuni, çifti britanik, vajza arabe, maqedonasi, etj, gjithësecili identifikues i historisë së popullit të vet përmes

(Vijon në faqen 13)


*ndryshe, ndjenja të reja,*” shkruan ai. Një përvojë transcendent e cila rezultoi me akordimin e titullit “Profesor” dhe medaljen e lartë “Kryqi i artë i kalorësit të shkallës I” nga Presidenti i Austrisë, medaljen “Nderim i Republikës” nga Kryeministri i Austrisë, medaljen “Civi Europaeo Preamium” (Qytetar Evropian) nga Presidenti i Parlamentit Evropian, e vlerësime të tjera të panumërta në SHBA, Itali e gjetkë, të cilat e plotësojnë, pors një film kinematografik, narrativën e pabesueshme të një emigranti të thjeshtë i cili dëgjon britmën e brendshme të artit, dhe nga një spektator në ndenjësën e fundit të sallës në teatrin e jetës, arrin ta përçojë forcën krijuese si një titullar i dalluar mbi skenën e rezervuar veç për ata që bartin titullin “homo universalis.”

E megjithatë, dallohet qartë te veprat e triologjisë *Kreuztanne*, se boshti i genies, i artit, penës, dhe mendimit të Fates është Vlora. Ajo mbetet Itaka e tij: “*Mos e hiq Itakën nga sytë, rikthimi yt atje është i paracaktuar dhe mos e merr me ngut udhën, le të zgjasë edhe disa vite më shumë, e të rikthehesh i plakur në ishull, i pasur në kujtime.*” “*Mos e harro nga u nise!*” shkruan ai, jo vetëm për lexuesin por si një kujtesë për veten, “*Mos e harro Vlorën. Ajo do të mbetet Itaka jote,*” një embleme shpirti.

Këto fjalë janë një imazheri e gjallë, tinguj nostalgjie, apo skena përmbullëse të filmave neo-klasik si ato të Giuseppe Tornatore, fjalë që na pëshpërisin në vesh: Rrugëtova sa më shpejt të mundja, sikur po arratisesha nga malli, nga pafajësia, nga ajo. Koha ka kaluar shpejt dhe unë kam dashuruar shumë qytete. Dhe teksa ato më kanë mbajtur afër e nën përqaftimin e tyre, duke më pyetur në heshtjen krenare nëse do t’i kujtoj gjithmonë, unë u jam përgjigjur: “Po, do t’ju kujtoj.” Por i vetmi vend që nuk e kam harruar asnjëherë është ajo që nuk më pyeti kurrë... Vlora. Ndaj edhe britma e shpirtit të Fates nuk shurdhet kurrë: “*Mos e harro Vlorën.*”

Kjo kampanë që tingëllon nga brenda me tinguj modestie na kujton perandorin e shquar romak Marcus Aurelius, i cili, i dashur nga njerëzit e i adhuroar prej tyre pors perëndi, caktoi një prej sklevërve të tij, që, teksa ai ecte në rrugët e Romës nën brohoritjet dhe përluljen e romakëve, t’i pëshpëriste në vesh perandorit në çdo hap: “Je vetëm njeri. Je vetëm njeri.” Edhe Fate Velaj, me të gjitha arritjet, udhëtimet dhe ekspozitat e tij anëmbanë botës, i bindet vullnetshëm zërit të qenies së vet: “*Mos harro nga vjen. Mos e harro Vlorën. Ajo është Itaka jote.*”

Thuhet shpesh, rëndomë, se dikush ka penë të fortë për të shkruar, ka dorë për të



Botimi i ri voluminoz “Lufta civile në Shqipëri” është fryt i hulumtimit dhe trajtimit shkencor të dokumenteve nga arkivat e Shqipërisë, Kosovës, Anglisë, Italisë, Jugosllavisë, Gjermanisë etj, për Luftën e Dytë Botërore që dhe hedhin dritë e vërtetojnë kuadrin e luftës civile në Shqipëri (1943-1945), një luftë e brendshme, e organizuar dhe e armatosur ndërmjet forcave politike e luftarake, përfshirë edhe masat popullore që i mbështesnin ato, një luftë me pasoja tragjike e shkatërrimtare, jo vetëm për atë kohë.

Qysh në krye autori bën të qartë dallimin midis luftës së popullit shqiptarkundër pushtuesve italianë e gjermanë, pra Luftës Antifashiste (1939-1944) dhe Luftës Civile ndërmjet shqiptarëve (1943-1945), që është objekt i këtij studimi.

Lufta e popullit shqiptar kundër pushtuesve italianë e gjermanë ishte një luftë patriotike, një luftë e drejtë, që i shërbeu çlirimit të vendit dhe kauzës së përbashkët kundërfashiste e liridashëse të popujve përgjatë Luftës II Botërore. Në këtë luftë kanë marrë pjesë dhe kanë ndihmësuar gjithë faktorët antifashistë: Lëvizja Nacionalçlirimtare, Balli Kombëtar, Legaliteti, Krerët e Veriut, Lëvizjet e pavarura të Gani Kryeziut, Muharrem Bajraktarit, Ramë Mujës, Mehmet Ali Bajraktarit dhe të aktorëve të tjerë.

Ndërsa Lufta Nacionalçlirimtare, e udhëhequr nga PKSH, është një pjesë e saj luftës antifashiste, siç është pjesë edhe lufta e faktorëve të tjerë. Autori çmon luftën e partizanëve kundër pushtuesve dhe dëshmorët e rënë, ashtu siç vlerëson edhe luftën e ballistëve, legalistëve dhe luftëtarëve të tjerë antifashistë, si edhe dëshmorët e tyre.

Por, përpjekja për ta paraqitur Luftën NÇ në të kaluarën por edhe sot si luftën e vetme të shqiptarëve kundër pushtuesve nazifashistë, është një tendenciozitet politik, një spekulim e përvetësim historik nga ana e udhëheqësisë komuniste dhe e historiografisë së saj, për të marrë e mbajtur pushtetin monist, për të mitizuar Luftën Nacionalçlirimtare dhe Enver Hoxhën, si dhe për përfitimë politike.

Lufta Nacionalçlirimtare ishte krahu i armatosur i Partisë Komuniste dhe realisht, por edhe ligjrisht, nuk mund të ishte apo të konsiderohet si lëvizje e armatosur e gjithë shqiptarëve.

Aq më tepër që Lufta nacionalçlirimtare nga një luftë kundër pushtuesve, u tjetërsua në vitet 1943-1945 kryesisht në luftë të përgjakshme për pushtet dhe komunizëm, luftë kundër kundërshtarëve politikë, madje edhe kundër atyre patriotëve që luftonin realisht kundër gjermanëve për një Shqipëri të lirë, demokratike e perëndimore. Një luftë NÇ që në fund sollti në fuqi regjimin stalinist dhe e vendosi Shqipërinë në Perandorinë komuniste të Lindjes.

E.Hoxha e ngriti dhe e lartësoi kultin e tij dhe të Luftës Nacionalçlirimtare, si lufta e vetme e popullit shqiptar kundër pushtuesve nazifashistë, që të monopolizonte luftën, rrjedhimisht edhe për pushtetin e vetëm absolut të tij dhe të PKSH, si edhe për të mbuluar apo mohuar krimet e luftës civile, të urdhëruar nga ai vetë dhe të nxitur e mbështetur nga tutorët komunistë rusë e jugosllavë.

Edhe historiografia komuniste u përpoq për gjysmë shekulli dhe vijon edhe sot ti trajtojë në mënyrë të njëanshme e të falsifikuar ngjarjet dhe personazhet e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri për qëllime politike e ideologjike.

Luftën kundër Ballit Kombëtar, mandej edhe Legalitetit dhe faktorëve të tjerë e nisi PKSH menjëherë përsëri prishjes së kuvendit të Mukjes. E.Hoxha urdhëroi “**Me forcë dhe me armë ta marrim në dorë pushtetin. Ballin duhet ta likujdojmë pa mëshirë nga çdo anë qoftë**”.

Udhëheqësit e LNÇ E.Hoxha, M. Shehu, Koci Xoxe, Hysni Kapo, Dali Ndreu, Shefqet Peçi etj ishin terroristë dhe e futën frymën dhe praktikën terroriste në Luftën NÇ për zhdukjen pa mëshirë të kundërshtarëve politikë dhe ideologjikë.

Mid’hat Frashëri, në emër të Ballit Kombëtar, bënte apel për të ndalur luftën luftën civile dhe për t’u bashkuar si vëllezër në luftën kundër pushtuesve fashistë: “*Sot është koha për një FRONT të çeliktë kundër armikut okupator dhe kundër horrave që e pasojnë. Ky front i përbashkët është gatuar me gjakun e heronjëve tanë: Qemal Stafa e dha kushtrimin dhe i fali atdheut gjënë më të shtrenjtë që kish : jetën. Jashar Cakrani e dëgjoi edhe ai atë kushtrim, duke rënë martir për atdhenë. Me qindra të tjerë kaluan mbi gjurmët e gjakut të dëshmorëve dhe*

## Ribotohet libri “Lufta civile në Shqipëri 1943-1945”

# KONTRIBUT I ÇMUAR I HISTORIANIT URAN BUTKA

Nga Erald Kapri

*vaditën me gjakun e zëmërës së tyre këtë tokë arbërore ....Le të luftojmë të bashkuar rreth fjalëve që na lanë të parët tanë: JA VDEKJE, JA LIRI! JEMI VËLLEZËR, S’NA NDAJNË DOT! »*

Shkaku kryesor i Luftës Civile ishte çështja e pushtetit. Frika e pushtetit mund të ndahej me forcat e tjera politike, apo mund të merrej prej tyre me zgjedhje të lira pas luftës, e çoi PKSH dhe E.Hoxhën në atë qëndrim arbitrar dhe në atë akt antidemokratik, që kishte për qëllim marrjen e pushtetit me forcën e armëve, sipas teorisë marksiste-leniniste, duke eliminuar faktorët e tjerë politikë, gjë që i çelte rrugën pushtetit totalitar dhe instalimit të diktaturës në Shqipëri. Ndërhyrja dhe roli luftënxitës i emisarëve të PKJ, për interesat e tyre hegjemoniste dhe shoviniste ndikuan në tjetërsimin e Luftës Antifashiste në Shqipëri në një luftë civile

Mandej në këtë luftë u detyruan të përfshiheheshin edhe Balli Kombëtar e lëvizjet e tjera të asaj kohe, si edhe pjesa më e madhe e popullsisë.

Kjo luftë është e evidentuar dhe dokumentuar gjerësisht në këtë libër me akte, dokumente e prova shkresore në 1555 referenca arkivore.

Pjesa dërmuese e dokumenteve janë urdhra, qarkore, komunikata, raporte, fjalime, kronika, urdhër-operacione, letra, trakte, radiograme, telegrame, ditarë etj. të vetë drejtuesve kryesorë të Luftës NÇ (komandantë e komisarë) si edhe raportime të shtabeve të korparmatave, divizioneve, brigadave e batalioneve të Ushtrisë NÇ, të shkruara me dorën e tyre drejtpërdrejt në zjarrin e luftës civile, që ruhen në Arkivin Qëndror të Shqipërisë, Arkivin e Forcave të Armatosura, Arkivin e Ministrisë së Brendshme dhe në muzeumet qendrore e lokale, të cilat përbëjnë lëndën e parë të këtij botimi dhe që nuk mund të rrëzohen apo të tjetërsohen. ....Gjithashtu, është trajtuar e dokumentuar edhe edhe nxitja dhe veprimtaria antishqiptare e politikës jugosllave dhe e agjentëve të saj në Shqipëri si Miladin Popović, Dushan Mughosha etj për shpalljen e shpërthimit të Luftës civile në Shqipëri dhe tërheqjen e saj pas qerres jugosllave.

Luftën civile në Shqipëri e kanë pohuar dhe raportuar thuasjse të gjithë oficerët britanikë, që kanë vepruar në atë kohë luftime në Shqipëri. si B.Maklen, J. Emery, D. Smajl, P.Kemp, T.Simkoks, G.Sejmor, A.Hibbert, A. Nikols, majori Oliver,

Gjenerali Dejvis etj, që janë trajtuar gjerësisht edhe në librin tim “Sekretet e Luftës”.

Në botimin e Butkës “Lufta Civile në Shqipëri” janë trajtuar me profesionalizëm dhe paanshmërisht ngjarje e protagonistë të luftës civile në të gjitha krahinat, madje edhe në fshatrat e Shqipërisë, që nga Vermoshi e deri në Konispol, madje edhe në tevat shqiptare jashtë kufijve, sepse kjo luftë përfshiu gjithë hapësirën shqiptare, por ishte veçanërisht e përgjakshme në krahinat me dominancë nacionaliste si Vlora, Mallkastra, Gjirrokastër, Kolonja, Korça, Devolli, Pogradeci, Dibra, Mati, Mirdita, Shkodra, Luma, Malësia e Gjakovës etj dhe që kulmoi në Malësinë e Madhe dhe Kelmend.

Lufta civile nisi menjëherë gjerësisht pas vendimarrjes në Konferencën e Labinotit 4-9 shtator 1943 dhe qarkores së Enver Hoxhës te 9 shtatorit për luftë të armatosur kundër Ballit Kombëtar. E pranon edhe historiani Paskal Milo, kur thotë “Letrat e Enver Hoxhës dëshmojnë pa asnjë mëdyshje se PKSH ishte nismëtarja e veprimeve të armatosura kundër Ballit Kombëtar”. Britaniku Julian Emery, konstatonte- “Enver Hoxha i kishte sulmuar ballistët në mënyrë që të mos ndante me rivalët trofeun e pushtetit politik. Kjo luftë civile nuk kishte asnjë lidhje me Luftën për çlirimin kombëtar, të cilën të dyja palët e kishin nisur ta ndiqnin në fillim. Ishte për të ardhur keq që Lufta Civile kishte marrë përparësi mbi luftën për çlirim”.


Mid’hat Frashëri që u përpoq me gjithë mënyrat ta ndalonte Luftën Civile, shkruante “Me luftën Civile komunistët filluan terrorin më të keq që ishte njohur ndonjëherë në historinë e Shqipërisë”

Ndërsa E.Hoxha deklaronte - “Ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi nëse në luftën për asgjësimin e Abas Kupit, do të gjejmë vdekjen edhe oficerët anglezë që rrinë me të”. Pra i quante armiq edhe ata misionarë britanikë, që ndihmësonin luftën antifashiste, por kundërshtonin luftën civile mes shqiptarëve, të shkaktuar nga komunistët.

Përgjatë Luftës civile 1943-1945 janë realizuar luftime frontale dhe partizane mes komunisteve dhe nacionalistëve, masakra kolektive dhe mijëra vrasje politike të paligjshme, pushkatim i robërve të luftës, pushkatim i njerëzve të pafajshëm, tortura fizike, djegie shtëpish dhe fshatrat të tërë, konfiskim i paligjshëm i pasurive të tundshme e të tjera, pra krime luftime dhe krime kundër njerëzimit.

Autori sjell para lexuesve dokumente për një luftë civile në tërë Shqipërinë, duke nxjerrë shkaktarët dhe pasojat tragjike të saj. Mjafton të përmendim masakrën e Devollit 8 shtator 1943, menjëherë pas Konferencës së Labinotit 4-8 shtator 1943 që e shpalli zyrtarisht luftën civile, ku u masakruan pabesisht, u therrën me thika dhe u vranë nga komunistët gjashtë nacionalistë të shquar: mes tyre edhe kosovari Zija Gashi. Dr.Kasimatin e prenë me thikë në fytyrë duke i thënë: “Hajt tani, folë edhe një herë për Shqipërinë etnike”.

Në luftën e Duketit 30 nëntor 1943 që zgjati 14 orë, Brigata I S e mori urdhërin nga Dushan Mughosha “**për me e shkelë tue përdorë zjarrin ma e tmerrshëm Dukatin nationalist**” U vranë qindra vetë nga të dy anet, u plagosën edhe disa gra, viktima të luftës civile. Në këtë betejë frontale mori pjesë edhe batalioni italian Antonio Gramshi, që qëlloi me altieri fshatin,



## URAN BUTKA

# Lufta Civile në Shqipëri

1943-1945









**MËKATI YT**

Më shpoi gjëmbi i zi i trëndafilit tënd.

Nga dhimbja  
U zbardh  
Hija ime mbi dhe.

**ZOGJ TË VERBËR**

Sa e lodhshme më bëhet udha  
Kur vij tek ti.

Zogj të verbër  
Hapat e mi.

**PËRVUAJTJE**

Gjithë ditën rri në dritare  
Përgjeruar pas teje  
Pa mend.

Kur vjen mbrëmja  
Dielli perëndon,  
Në kindat e fustanit tënd.

**GRINDJE MARTESORE**

Mbaroi edhe muaji i mjaltit  
Nga gishtat  
Filloi tu rrjedh  
Shkëlqimi i unazave.

Sa të urtë janë fëmijët  
Ende të palindur!

**DHIMBJA E IKJEVE**

Këtu është kufiri i mjegullës!

Këtej, ujqërve u është mpirë nuhatja  
Nuk ulërasin më  
Ti je krejt e lirë të ikësh  
Si një ujkonjë e vërtetë  
Në arratinë tënde të marrosur.

Mos më pyet se cilat ikje dhëmbin më shumë  
Nuk pyeten kurrë të vrarët e fatit.

Ti e di, pas teje do vijë një verë e thatë, e thatë  
E shpirti do më bëhet  
Daulle beduini.  
Pastaj do vijë një korb  
Do rrah me sqep lëkurën e saj,  
E do gjemojë gjithë shkretëtira.

Unë do zhytem në mjegull pa dëgjuar  
asnjë tingull  
Si një uj i vetmuar  
Me nuhatje të mpirë, pa ndjesi.  
Një uj i uritur  
Që bren me dhëmbë drapërin e hënës  
Të ushqehet me thërmia drite.

Mos i pyet kurrë të vrarët e fatit  
Të të flasin për ikje.

**KËNGA E PERLËS SË ZEZË**

Isha dikur një burrë prej zjarri!...  
Ndizesha e shuhesha  
Nga xixat që shkrepnin  
Qerpikët e tu.

Mbi zambakët e çelur  
Këndonin zogjtë e parajsës  
Udhës kur vija tek ti.

Befas qerpikët e tu i ngriu dimri i ikjeve  
E të fshehu në një guvë gurësh  
Mbuluar me ujra të njelmët.

Ju luta sirenave të të gjenin  
Të sillnin sërish tek unë,  
Por dimri i egërsuar  
Shfrynte mbi mua gjithë tërbim.

Ti u bëre perlë e zezë...  
Tashmë del e këndon mbi ujra  
Këngën e fatit tim.

**DIELLI PERËNDON NË KINDAT  
E FUSTANIT TËND**

*Cikël poetik nga Nuri Plaku*

**LUMI I THARË**

U tha edhe ky lum...  
Mbi zall, dergjen trugje drurësh të kalbur  
Skelete peshqish, gaforresh, bretkosash  
E gjithfarë mbeturinash, pa formë.

Unë qendroj para tij, e digjem dalëngadalë  
Në zjarrin e zi të korbave  
Që krokasin me ulërimë në shtratin e  
vdekur  
Sikur po i bëjnë, të fundin gjyq.

Tej në horizont,  
Shfaqen katër pulëbardha  
Me katër lumenjtë e parajsës mbi shpinë  
Që vijnë drejt meje  
Duke fluturuar kryq.

**DRITA E BARDHË E MJELLMAVE**

Kur luanin mjellmat e reja në liqen  
Peshkatarin plak më thoshte i gëzuar:  
Është koha të njohim vetveten!

Kur vdisnin mjellmat e moshuara në breg  
Peshkatarin më thoshte i menduar:  
Është koha të njohim vdekjet tona!

Sa e bukur është drita e bardhë e mjell-  
mave  
Kur buron nga gjoksi i një burri!

**BULEVARD**

Sa herë shetisja në këtë bulevard  
Nga gurët e tij të lëmuar  
Buronte një muzikë e fsheht  
Që vetëm unë e dëgjoja.

Dikur atë muzikë  
Fillova ta luaja vet.

Bulevardi tretej brënda meje  
Unë rritesha,  
E bëhesha qytet.

**MESNATAT E QYTETIT TIM**

Mesnatat e qytetit tim  
Luajnë shah  
Me statujat e parkut.

Mbreti  
Përvidhet herë – herë  
Nga fusha e betejës  
E fshihet  
Në një sy të verbër kusari.

Unë e vështroj nga dritarja  
E gjerbi i etur  
Dritën e mugët të yjeve  
Si çaj trëndafil të zi.

**MALLKIMI I QYTETIT**

Tri herë më mallkove o qytet  
Pa më parë në sy.

Mua mu dukën  
Si tri këngë gjeli në mesnatë.

Kurrë se besova mallkimin tënd prej ati!

Tri qirinj ndeza në altarin e kishës  
Të përcillja te Zoti  
Tri lutje për ty.

Tri lutje o qytet  
Për tu parë  
Sy më sy.

E ti prapë nuk munde...

Në dritën e qiririt të tretë  
Mu shfaq emblema jote  
Në dhëmbët e një Jude.

**UDHA E MËKATIT**

Është një udhë  
Të nxjerr në katër udhë.

Shi nuk bie mbi të  
As bar nuk mbin  
Veç fryn një erë e ftohtë, e ftohtë  
Që t'i shkul mendimet nga koka  
E të bën vjeshtë.

Është një udhë  
Që sa herë kalon dikush  
Këndon një hutin.

Sapo mbërrin në fundin e saj  
Katër udhë të tjera  
Bëhen kryq  
E të kërcëjnë mbi shpinë.

**BURRË DIMRI**

Kur u nisa  
Vesha këpucë të uritura  
Me shoje të dhëmbëzuar  
Të kapesha fortë pas udhëve  
Të bëhesha burrë dimri.

Para meje ishin nisur burra të tjerë  
Me shoje këpucësh të dhëmbëzuar  
Shkelnin mbi flakët e zjarreve  
E nxitonin të thinjeshin.

Ndanë zjarreve të shuar  
Përgjonin ujë të zinj të fatit  
Me eshtra udhëtarësh në gojë.

Ishte udhë e pafund ajo udhë  
Natën të çonte diku  
Ditën të kthente sërish

Pa mbritur askund.

Diku ndala  
Vara xhakëtën në sqepin e një zogu  
Dhe u ula të shlodhesha.

Pluhuri i këpucëve mu fut në damar  
E mu bë baltë e kuqe  
Përzier me grimca hiri.

Isha bërë  
Burrë dimri.

**SOT IKU KOMSHIJA IM I FUNDIT**

Sot iku  
Komshija im i fundit.

Moti gjemoi tri herë  
Pastaj fryu erë e ftohtë  
Dhe dëbora e zezë e oxhakëve  
Ngriu mbi çati.

Një shami grash  
E lagur nga lotët  
Mbeti harruar  
Në gozhdën e murit.

Sot iku  
Komshija im i fundit!...

**KËPUCËT E AMELIAS**

*Amelias, mbesës sime*

I mbush me përralla këpucët e vogla të  
Amelias  
Dhe shkoj përditë në parkun e lojrave  
Të kalëroj me kalin e drunjtit.

Është kali që luante vogëlushja ime në  
verë  
Ai më njez dhe hingëllin me zërin e saj.  
Mua më duket se edhe qesh si ajo  
Po këtë nuk e them, se e di që kuajt nuk  
qeshin...

I vendos këpucët mbi shalë  
Rrotullohem bashkë me të duke e mbajtur  
për kapistalli  
E i tregoj një përrallë të bukur  
Njësojë si Amelia.

Kur mbaron përralla, kali ndalon. Mjaft  
për sot!  
Njerëzit presin radhën të kalërojnë fëmijët  
e tyre  
Dikush më shikon i çuditur, por aq më  
bën.  
Nesër do vij përsëri, ti tregoj kalit përrallën  
tjetër  
Mjafton që ai të hingëllijë me zërin e saj  
Mjafton të qeshi me qeshjen e saj, dhe pse  
nuk është e vërtetë.

Amelia nuk më shikon, është larg, në  
mërgim  
Kjo nuk ka rëndësi  
Ajo më ka lënë këpucët e mbushura me  
përralla  
Dhe këtë kal të drunjtit që hingëllin me  
zërin e saj, plot jetë!

**SYTË E MILONGONAVE**

Unë e flisja dikur gjuhën e fshehtë të mil-  
ingonave  
Dhe adhuroja heshtjen e tyre prej dheu.

Kur ndodhte ndonjëherë të braktisja veten  
Ato më mbërthenin me nofullat e mprehta  
E unë rikthehesha sërish në adhurim.

Pastaj më shihnin me pasqyrëzat e syve  
Mbushur me dritë të zezë  
E më rrëfenin udhën e vetëtimave.

Gjithë jetën jam endur në atë udhë  
Të gjeja gurët e rrufeve  
Të kalisja shpatën e heshtjes.  
Por gurët qiellorë si gjeta kurrë  
Dhe tehu i shpatës shkëlqente vetiu në  
dorën time.

Një ditë e kuptova...  
Ata gurë ishin sytë e tyre të vegjël, të vegjël  
Mbushur me dritë të zezë vetëtime.





Karikaturë nga Arben Mexsi

**ZJARRI NË SYTË E TU**

është zjarri në sytë e tu  
që dua ta zë, përvëlueshëm ta pijë

është drita e syrit tënd  
që dua ta puth  
në verbimin e dritës sate  
të më erret nata

është kroi i zjarrtë në sytë e tu  
ku dua të shuaj etjen  
të pi etshëm çdo pikë zjarri  
të mos mbetem  
ujëvarë e zezë e dëshpërimit

është lumi i bardhë vështrimit tënd  
që dua të më marri me vete  
duke dalë nga shtrati

është shigjetë e ndezur syrit tënd  
që dua të më ngulet në zemër  
të shpojë vrimë në shpirtin tim

është loti në syrin tënd  
ku më qanë dita ime...



## VITET PA TY

Cikël poetik nga Qerim Raqi

**NDEZJA E VARGUT**

jam unë  
apo fryma jote  
që më dehën  
frymëzimin?  
merr trajtë vargut tim  
nuk po shkruaj  
unë vetëm ndjenjën  
paksa po e shtrydh  
po e ndezë  
Ti  
në vargun tim  
rritesh  
nuk kanë vend fialët  
tërë hapësirën ke zënë  
vargu merr zjarr  
digjet vargu im  
aromë jotja puthja shkruan  
fjala nuk më bindet  
ti më djeg  
vargun  
shkronjat  
do më djegësh të tërin?  
jam unë a ti  
që shkruan  
vargun tim?

**DALLGË TË ÇMENDURA MALLI**

në këtë ditë  
të çmendur  
etjeje  
më pijnë kujtimet

në këtë det  
të çmendur  
zemrash  
lahem mungesës sate

në këto dallgë  
të çmendura  
malli

**NË SYTË E TU**

në sytë e tu  
kam lexuar më shumë  
se në tërë letërsinë botërore

në shpirtin tënd  
luftërat e të gjitha luftërave  
i kam ndërjet

në heshtjen tënde  
të gjitha heshtjet e botës  
kanë rënë si perandorët

në fjalën tënde  
të gjitha shpresat...

**KLITHMË E ËMBËL DASHURIE**

kur me syrin gështenjë më vështrove  
unë në heshtje putha  
dritën në sytë e tu

kur dorën ma shtrëngove  
një forcë e pashpjegueshme  
hyri në trupin tim

me përaçafimin tënd  
të gjitha pikëpyetjet e jetës sime  
morën përgjigje

kur buza jote  
preku buzën time  
togje pulëbardhash më dilnin nga krahërori

kur mollët ...  
ah, mollët kur i shtrydha  
pjalme jete mbushej shpirti im

qumësht i bardhë yjesh

pema jonë në rrënjë i bënte frutat

kur bëmë dashuri  
të gjitha qelizat u mblodhën në një pikë  
vlimi  
për të shpërthyer pastaj në një klithmë të  
ëmbël kënaqësie

**SIMFONIA ...**

të rrahura të shpejtuara zemrash  
me ritmin e ndjenjës së bardhë  
ëmbëlsi rridhte damarëve të gjakut  
lumi i puthjeve vërshonte  
kontinentit të Qetësisë  
një urë shprese ndërtohej në ato çaste  
pika zjarri pinin etjet  
malli puthte etshëm

në gjirin e detit tënd  
unë pija jetë  
çdo gjë bashkohej me tingujt blu  
në allegro...

a ka poezi, simfoni më të bukur  
se ajo që krijohet  
me ritëm zemre?

**SHTRIRJA NË PLAZH**

e sheh?  
Këtu ka shumë thonj  
eshtra nën dhë varrosur

e ndjen?  
flakën nën këmbet tona  
përvelon rëra  
djegia jonë e ftohtë

djegur  
nën shpinën tonë të kallur  
nën tokë  
tërmete qytetesh të rrënuara  
ka tronditje mijevjeçare dridh –

je?  
permbys-je këtu  
thonj ka kthetra, e dashur  
nën këmbët tona  
rëshqet dheu ecja jonë  
djersë e ftohtë si vdekja

**ADONIS I BARDHË**

A-do-nis?  
ankthe afroditash vuajtje persefonash  
mëri aresi gjel-o-zi më mbytën  
tani po thyhem herë në ngjallje herë në  
vdekje  
afrodita më kërkon në mbidhë persefona në  
nëndhë  
do më shqyejnë do më shqyejnë menadat e  
çmendura të dionisit  
djalerisë së vonë moshës së bardhë  
po ia mbysh lajkat po ecën pa krye  
tërë jetën në kërkim sytë e mi  
tani thyeju në daç më thua aq më bën  
ti po ecën vijave të bardha po hapëron bardh  
derisa të më marr koha  
a unë kohën  
të nis  
i bardhë Adonis  
A-do-nis?

**KUR BEJMË DASHURI**

toka nuk sillet  
rrotullohem i ne  
bota  
rrudhet mblidhet në çast  
kohëhapësira

(në vdekjen e vogël  
sytë tanë Diell)

fluturojmë  
si lkari afër diellit  
dhe s'digjemi

në ballin tim shkruhet  
kujtesë e ofshamës sate  
gjuha jote vizaton  
harta të pista gojës sim

gjeografia e shpirtit zgjerohet  
në nivel gelizash  
kënaqësia kënaqet

kur bëjmë dashuri

**KALLJA E MUNGESËS**

ende po ges zjarr  
nga goja epshin tënd  
gjuha ime flakë

ende po qet avull  
lëkura ime e djegur  
nga lëkurë e jotja

zëri yt ende përplaset  
mureve të veshit  
vibracionet e afshit  
dridhin dëgjimin tim

syri im ende ka ngrirë  
imazhin tënd  
me njërin sy tëndin po shoh  
zbrazëtinë e mbetur

vetëm aromën tënde  
pranon shqisa ime  
të papërsëritshmen aromë

truri?!!!  
truri po kallet  
fantazmë e trurit je bërë  
ëndërr e ëndërres sime

ende po qes avull  
Zjarr po qes e dashur  
tronditja ime  
e epigendër të mungesës

**VITET PA TY**


vitet,  
padiktueshëm hanë vetveten,  
hyjnë në vrimën e zezë

universi im tkurret  
në një pikë  
vetmie

thika të dhembjes  
më hyjnë në asht  
kthetrat e mungesës sate

gati sa nuk vdes  
nga malli  
pëlças





Majtas: Gabriel García Márquez-i me bashkëshorten e tij, Mercedes Barcha, dhe të bijtë, Gonzalo, majtas, dhe Rodrigo, më 1980. Djathtas: Márquez-i në shtëpi në Mexico City më 1962. HARRY RANSOM CENTER; ALAMY

Para botimit të një romani të humbur "Shihemi në gusht", djali i Markezit, Rodrigo García, flet për demencën e babait, të bijën që mbajti të fshehtë dhe ngjarjen kur e goditi në fytyrë Mario Vargas Llosa

## JETA E FSHEHTË E GABRIEL GARCIA MARQUEZ

Nga Helena de Bertodano, për *The Sunday Times*

Rodrigo García tregon një histori Rzbavitëse për të atin, Gabriel García Márquez-in, në shtratin e vdekjes. Një pasdite, disa infermiere po qëndronin te këmbët e krevatit duke diskutuar për kujdesin ndaj tij ndërkohë që García Márquez-i – i cili në atë fazë ishte "i zhytur në demencë prej vitesh" dhe pranë vdekjes – po flinte. "Zgjohet, sheh këto katër gra dhe thotë: 'Nuk mund t'ju palloj të gjithave!'".

Rodrigo – një variant më i gjatë e më i bëshëm i të atit, me vetulla të çrregullta, flokë kaçurrelë dhe me sjellje të butë – qesh teksa përshkruan këtë skenë. "Ishte mbresëlënëse që një njeri kaq i humbur në kohë, hapësirë dhe në njohuri kishte ende një sens humori. Nuk ia kishte idenë se ku ishte apo kush ishin ata njerëz, por prapë e dinte se do të ishte për të qeshur".

Ky prill shenjon përvjetorin e dhjetë të ndarjes nga jeta të García Márquez-it, autorit kolumbian që më 1982 fitoi çmimin "Nobel" në letërsi. Libri i tij më i vlerësuar, *Njëqind vjet vetmi*, i cili u botua më 1967 dhe ka shitur më shumë se 50 milionë kopje, u përshkrua nga *The New York Times* si "pjesa e parë letrare që prej Librit të Zanafillës që duhet të lexohet nga e gjithë raca njerëzore". Romani "i fundit" i papritur nga García Márquez-i, *En Agosto nos Vemos, ose Shihemi në gusht*, do të botohet javën tjetër për të përkuar me përvjetorin e vdekjes së tij. Një prej 25 librave të shumëpritur të vitit 2024 nga revista *Time*, është, thotë Rodrigo, "mbi një grua që viziton varrin e së ëmës çdo vit dhe çdo vit gjen një të dashur të ndryshëm". Rodrigo, 64 vjeç, thotë se ai dhe vëllai i vogël, Gonzalo, 60

vjeç, fillimisht kanë hezituar për botimin pasi babai i tyre, pavarësisht se shkroi dhjetë boca, nuk e ndjeu kurrë se kishte mbaruar. "Unë dhe im vëlla e justifikojmë veten, - shpjegon Rodrigo, - sepse babai ynë thoshte: 'Kur të kem vdekur, bëni ç'të doni! E rilexuan librin dhe menduam se kishte shumë më shumë vlerë se

ç'mendonte ai. Teoria ime është se ai humbi aftësinë për ta gjykuar librin".

I ati mendonte gjithashtu se *Njëqind vjet vetmi* nuk mund të ekranizohet, por gjithsesi vëllezërit i kanë dhënë dritën jeshile një përshtatjeje në Netflix, me kushtin që të filmohet në spanjisht në Kolumbi. "Një prej problemeve të tim



Rodrigo në shtëpi, me një portret të babait, foto nga AUSTIN HARGRAVE për THE SUNDAY TIMES MAGAZINE

ati ishte se nuk mund të përshtatet në një film treorësh me Al Pacino-n si (personazhi kryesor) kolonel Aureliano Buendía".

Në vend të kësaj, do të dalë këtë vit me dy sezona, secili me tetë episode, 16 orë televizive. "Është produksion shumë i pasur", - thotë Rodrigo, i cili gjatë tre dekadave të fundit ka jetuar në Los Angeles dhe është këshillues në produksion. Është i martuar me Adriana-n, mësuese. Kanë dy vajza të rritura, Isabel dhe Ines.

Regjisor i suksesshëm filmash në Hollywood dhe drejtor televizioni më vete, Rodrigo njihet më së shumti për filmin zemërthyes *Nine Lives* (2005), me aktorë Robin Wright Penn, Glenn Close, Holly Hunter dhe Amanda Seyfried, dhe dramën historike *Albert Nobbs* (2011), sërish me Close. Pak javë më parë, Netflix nxori *Familia* (2023), filmin e tij të parë në gjuhën spanjolle, një portretizim prekës i një familjeje meksikane në momente krize, të detyruar të shesin fermën e tyre të ullinjve.

Modest dhe i thjeshtë, Rodrigo thotë që i ati shqetësohej se mos fama e tij do t'i pengonte fëmijët. Në fakt, shumë njerëz në industrinë e filmit nuk e dinë se cilët janë prindërit e tij. "Kam qenë shumë i vendosur për të gjetur rrugën time në botë", - thotë. - "Dhe i vendosur se të isha i biri i tim ati nuk do të ishte tipari kryesor i identitetit tim dhe nuk do të më paralizonte në asnjë mënyrë".

I ati, i njohur nga miqtë dhe familja si Gabo, kishte një nivel pop-kulturor fame. "Për shkrimtar, ai ishte si Mick Jagger", - thotë Rodrigo. - "Shkonte rregullisht te një kioskë gazetash dhe njerëzve u binte të fikët: 'Oh, Zot, je këtu!'".

Gjithsesi, për një njeri kaq të njohur, dihet fare pak mbi jetën e tij personale, të cilën e ruante me zell. "Çdokush, - i tha një ditë García Márquez-i të birin, - ka tri jetë: publike, personale dhe të fshehtë". Vetëm pasi vdiq u bë e mundur të bëheshin bashkë disa pjesë nga jeta e tij jashtë syrit të publikut.

Pak vite më parë, u përhap një pëshpërimë se García Márquez-i kishte një fëmijë të fshehtë. Më 2021, Rodrigo la të kuptohet thashethemi kur përshkroi vajtuesit në varrimin e të atit te *Lamtumirë Gabo dhe Mercedes*, një kujtim kushtuar prindërve të tij: "Për një çast më vjen në mend se ndoshta dikush nga jeta e tij e fshehtë mund të ishte mes këtyre njerëzve".

Ulur në një kafene italiane pranë shtëpisë së tij në Santa Monica, duke pirë *matcha* me qumësht tërshërë, Rodrigo shpjegon se çfarë donte të thoshte. "Kjo ishte një shkelje e fshehtë syri për ata që e dinin". I referohet faktit se babai i tij kishte një vajzë, Indira. Në fillimet e viteve nëntëdhjetë një grua e re meksikane e quajtur Susana Cato mori pjesë te një *workshop* për skenarë në Kuba ku jepte mësim García Márquez-i. Gazetare nga revista *Cambio* në Meksikë, e intervistoi dhe filluan një marrëdhënie. Shpejt, Cato lindi bijën e tyre, Indira, tani në të tridhjetat, e cila mbajti mbiemrin e së ëmës. "Me aq sa di, e njihje që fëmijë dhe e vizitonte", - tha Rodrigo. - "Por, teksa humbi kujtesën, jam i sigurt se e pati të vështirë të ruante lidhjet me të".

Në të vërtetë, në dy vitet e tij të fundit nuk njihje thujse askënd. "E njihje mamanë time (Mercedes-in) si personin kryesor, alter egon, por nuk mendoj se ia dinte emrin. Por mua dhe vëllain nuk na njihje. Njëherë, mbaj mend se po ktheheshim nga një restorant për

te shtëpia dhe ai ishte pas me një prej vajzave të mia”, - thotë Rodrigo. - “Dhe mund ta dalloje se po e kapte ankthi se ishte një makinë plot me të panjohur”.

Rodrigo mban mend me detaje ditën kur babai i tha atij dhe Gonzalo-s për gjysmëmotrën e tyre – pak para se Indira të mbushte 18 vjeç. Është e paqartë nëse mamaja e dinte për ekzistencën e saj. “Nuk e dimë nëse e dinte”, - thotë Rodrigo. Mendimi i tij i parë ishte për vetë Indira-n. “Bashkë me vëllain e kontaktua, sepse ishim të shqetësuar se mos mendonte se e kishim shpërfillur gjithë jetën e saj”. Që nga ajo kohë janë takuar shumë herë. “Është shumë e këndshme. Unë dhe vëllai i kemi dhënë disa prej sendeve personale të babait, edhe pse kurrë nuk ka kërkuar gjë prej gjëje. Kjo mjafton të të bëjë ta kesh shumë përzemër”.

Kur doli lajmi për atësinë e saj më 2022, Indira Cato tashmë e kishte krijuar identitetin e vet si shkrimtare dhe producente e suksesshme dokumentarësh në Meksikë. I pari, *All of Me* (2014) – për gratë të cilat ushqenin emigrantët e kapur pas La Bestia, “treni i vdekjes” që udhëton nga Amerika Qendrore drejt kufirit të SHBA-së – fitoi çmim në Meksikë.

Me sa di Rodrigo, i ati nuk ka fëmijë të tjerë. “Jam i sigurt se do të ishte shfaqur deri tani, duke kërkuar diçka”, - thotë me shaka.

Disa sekrete García Márquez-i i ka marrë me vete në varr me sukses, si ai që e shtyu njërin prej miqve të tij më të ngushtë, romancierin peruan Mario Vargas Llosa, ta godiste në fytyrë më 1976.

García Márquez-i e kishte takuar mikun e tij të vjetër në një premierë filmi në Mexico City. I kënaqur që e pa, i thirri “Mario!” dhe zgjati krahun për ta përqafuar. Vargas Llosa i hodhi një vështrim dhe e goditi në sy. Dhe kështu filloi një prej sherreve më të mëdha në historinë e letërsisë.

“Kam dëgjuar variante”, - thotë Rodrigo. - “Njëri ishte se Mario kishte lënë gruan e tij, Patricia-n, për dikë tjetër. Prindërit e mi kishin mbajtur anën e Patricia-s. Dhe nëse kishte ngacmuar babai Patricia-n, nuk e di. Por, të them të drejtën, janë të gjitha thashetheme”.

Dy shkrimtarët nuk folën më kurrë. “Nuk e pyeta asnjëherë pasi nuk ishte temë e këndshme”, - thotë Rodrigo, i cili i kujton mirë vitet kur i ati dhe Vargas Llosa ishin të afërt. “Jetonin një lagje larg nesh në Barcelonë. Shkonim në dreka të mëdha të dielave, stil shumë spanjoll. Fëmijët e tij ishin më të rinj se ne dhe njërit prej tyre i është vënë emri sipas nesh: Gabriel Rodrigo Gonzalo (emrat e parë të të tre burrave García Márquez)”.

Megjithëse miq të mirë, ishin shkrimtarë shumë të ndryshëm dhe kishin debate të gjalla për artet dhe letërsinë. “Mario ishte shumë artist dhe intelektual”, - thotë Rodrigo. - “Im atë ishte thjesht artist; lexonte vetëm gjërat që pëlqente. Për shembull, nuk e pëlqeu kurrë Proust-in dhe thoshte se *Remembrance of Things Past* ishte gjëja më e mërzitshme e më franceze që kishte lexuar”.

Ishte edhe shpërfillës ndaj veprave të tij, sidomos *Njëqind vjet vetmi*. “Arriti ta urrente atë libër, sepse për vite me radhë ishte *Njëqind vjet vetmi* kështu, *Njëqind vjet vetmi* ashtu. Dhe ishte vepër e vështirë për ta ndjekur. I referohej si *la pinche novela* – ‘romani i ndyrë’. Por sukseksi i *Dashuri në kohërat e kolerës*



Foto e padatur e familjes.

(historia e tij e dashurisë dhe plakjes, që u botua më 1985, tre vjet pasi fitoi ‘Nobel’-in) e pajtoi me *Njëqind vjet vetmi...* Mendoj se nga fundi e fali dhe ca më shumë”.

Çfarëdo të kishte ndodhur, Rodrigo mendon se babai i tij dhe Vargas Llosa donin të pajtoheshin. “Të mos ishte për gratë, do të ishin pajtuar”, - thotë. - “Po spekuloj, por në një pikë në vitet 2000 po i dërgonin sinjale me tym njëri-tjetrit. Por mendoj se dy gratë i shuan”. Pastaj

shton: “Im atë dhe Mario sigurisht e dinin (çfarë kishte ndodhur vërtet). Ose njëri prej tyre e dinte. Ose Mario mendoi se kishte ndodhur diçka që, në fakt, nuk kishte ndodhur”.


E intervistova një herë Vargas Llosa-n dhe e pyeta drejtpërdrejt pse e kishte goditur mikun e tij. “Nuk flas kurrë për këtë”, - tha. Tani, 87 vjeç, botoi atë që tha se do të ishte romani i tij i fundit, *I Give You My Silence*, vitin e kaluar.

Pak javë më vonë u takova sërish me

Rodrigo-n, kësaj here në shtëpinë e tij, një shtëpi e bukur spanjolle me stil kolonial në Santa Monica. E shoqja, Adriana, ma bën me dorë me gëzim nga kopshti, ku po krasit një pemë, dhe Rodrigo më tregon shtëpinë e mysafirëve ku qëndronin prindërit e tij gjatë vizitave të shpeshta. Fotot e familjes e tregojnë babain e tij simpatik me çizme firmato. “Donte të ishte më i gjatë, kështu që vishte gjithnjë këto çizmet italiane”. Në një raft librash është një version lodër i García Márquez-it. “E bënte për të qeshur”, - tha Rodrigo, teksa e uli poshtë. - “Është nga gjërat që shesin në treg në Kolumbi”. Një ari qiriri mban portretin e tij si një engjëll me krahë, nën fjalët “Shën Gabriel”, të cilin një prej vajzave të Rodrigo-s e kishte gjetur në Etsy, një tregues i sa thellë nderohet García Márquez-i, sidomos në Kolumbi, ku u lindi, dhe në Meksikë, të cilën e bëri shtëpinë e tij.

I lindur më 1927 në qytetin e vogël të Aracataca-s, pranë bregut karaibian të Kolumbisë, García Márquez-i u la prej prindërve të tij nën kujdesin e gjyshërve nga ana e mamasë për tetë vitet e para të jetës – pasi i ati, një punonjës poste dhe operator telegrafik, mori një punë më të mirë në qytetin e Barranquilla-s. Autori i përshkruan shpesh këto vite si më të lumturat e jetës së tij dhe ishte ndikuar fort edhe nga gjyshja, e cila ishte tejet supersticioze dhe besonte në fantazma e mrekulli, edhe nga gjyshi, i cili i dhuronte historitë e bëmave të tij heroike në Luftën Kolumbiane të Një Mijë Ditëve.

Më vonë studioi juridik në Bogota, ku edhe filloi karrierën e tij si gazetar gjatë La Violencia, luftës civile mizore dhjetëvjeçare që zgjati nga 1948 deri më 1958. Ai e ndërthuri këtë me shkrimin e poezive dhe historive të shkurtra, dhe rrjedhimisht botoi *Gjethurina* më 1955, një novelë ku prezantohet qyteti i trilluar



Márquez me Mario Vargas Llosa, 1967

i Macondo-s – bazuar në Aracataca, që më vonë formoi sfondin e *Njëqind vjet vetmi*.

Këtu ai eksperimentoi me disa prej teknikave, si manipulimin e kohës, që janë thelbi i realizmit magjik – kombinimi i rrëfimeve realiste me fantazinë, një stil që përcaktoi veprën e tij. Por ai nuk e pëlqente aspak etiketimin realizëm magjik, sepse i dukej se po përshkruante jetën siç ishte në të vërtetë në një qytet të vogël në Kolumbi. “Shumica e tyre kanë ndodhur vërtet”, - thotë Rodrigo.

Në gishtin e vogël të dorës së djathtë Rodrigo mban dy unaza të thjeshta argjendi. I heq dhe m'i zgjat që të lexoj mbishkrimin brenda: janë unazat e martesës të prindërve të tij, gdhendur me një shkrim të vogël emrat e tyre, Gabriel García and Mercedes Barcha, dhe data e lidhjes së kurorës: 21 mars 1958. U takuan për herë të parë fëmijë në vitet '30 në Sucre, qytet në Kolumbinë Veriore ku babai i Barcha-s punonte si farmacist. García e diti menjëherë se do të donte të martohej me të një ditë. “Im atë thoshte gjithmonë se ajo ishte personi më magjepsës që kishte njohur ndonjëherë”, - thotë Rodrigo.

Rodrigo u lind më 1959 në Bogota; dy vite më vonë, i tronditur nga klima politike në Kolumbi, García Márquez-i u shpërngul me familjen e tij në Mexico City, ku lindi Gonzalo më 1964. Pasi kishte kritikuar korrupsionin në qeverinë kolumbiane, García Márquez-i ishte bërë një figurë kontravere në vend dhe e kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij të mbetur në mërgim të vetimponuar.

Rodrigo e kujton të atin duke punuar thuasë në gjendje “transi” me *Njëqind vjet vetmi* – historinë e shumë brezave të familjes Buendía – në Meksikë. Ndonjëherë mamaja e dërgonte atë dhe të vëllain në studion e të atit me një mesazh. Shihet përtej tyre, nuk regjistronte asgjë, “humbur në një labirint rrëfimi”.

Kur ishte fëmijë, Rodrigo nuk e kuptonte sa pak para kishin prindërit e tij. “Kur e kujtoj, shtëpia jonë ishte fare bosh. Kishim nja dy dhoma pa mobilie. Mbjaj mend një krishtlindje kur zbrita poshtë dhe kishte jashtëzakonisht shumë dhurata. E pyeta babain ca vite më vonë për këtë dhe më tha: ‘Miq të dinin se ishim në vështirësi dhe dërguan dhurata’”.

Ndërkohë që i ati shkruante, e ëma rregullonte rreshtat e borxheve nga kasapi dhe merrej me qiradhënesin: “Prindërit e mi nuk kishin paguar qira për njëmbëdhjetë muaj.” Kur mbaroi dorëshkrimin, mamaja vuri peng tharësen e flokëve që të paguanin postën. “Fjalët e saj ishin: ‘Bën mirë të jetë i mirë’”.

Sapo u botua, libri arriti një sukses të menjëhershëm dhe u përkthye në anglisht më 1970. Familja u shpërngul në Barcelona për disa vite, ku prindërit e tyre ishin “jashtëzakonisht miqësorë”, thotë Rodrigo, me një rreth të madh miqsh, duke përfshirë shkrimtarin meksikan Carlos Fuentes dhe regjisorin spanjoll Luis Buñuel. “Buñuel ishte si një xhaxha spanjoll. Por ti e di se si është kur takon këta artistë të mëdhenj. Nuk rrjedh poezi nga to. Thjesht janë të shqetësuar se mos supa është e nxehtë”.

Si familje, ishin veçanërisht të afërt. “Pjesa tjetër e familjes nga të dyja anët ishte në Kolumbi, kështu që të katërt ishim si njësi e vetme, klubi katërsh”. Rodrigo shkoi në shkollë angleze edhe në Mexico City edhe në Barcelona, pastaj



García Márquez me Fidel Castro-n, mysafir i shpeshë. HARRY RANSOM CENTER.

studioi histori në Harvard. Prindërit e tij, thotë, ishin antiteza e prindërve helikopter. “Kanë ardhur të shkolla ime vetëm dy herë gjatë gjithë jetës sime”. Por hanim drekë familjarisht çdo ditë të javës. “Im atë gjithmonë kërkonte që të vinim në shtëpi për drekë, stil-latin në tre pasditë pas shkolle, për të na marrë në pyetje: ‘Si ju shkon jeta, ç’bëhet?’”

Në fund të viteve shtatëdhjetë filluan të kalonin periudha të gjata kohe në Kuba, ku García Márquez-i ndërtoi një miqësi të ngushtë me Fidel Castro-n, i cili ndonjëherë vinte të rrinte. “Ishte

pak mister se ku flinte Castro”, - thotë Rodrigo. - “Truproja e tij telefononte tim atë për ta pyetur nëse do të ishte në shtëpi atë mbrëmje. Im atë do t'i përgjigjej po dhe ata thoshin: ‘Mund të keni një vizitor. Dhe ‘mund’ do të thoshte ‘mund’. Dhe mund të nënkuptonte 10:30 të darkës apo 1:30 të mëngjesit”.

Në vitet tetëdhjetë, babai i tij ishte aq i famshëm sa, siç thotë Rodrigo, “që të binte telefoni në shtëpi, duhej vetëm të ulje receptorin”. Kujton një dalje me prindërit në Nju-Jork ca vite më vonë. “Dy gra argjentinase në mesomoshë bërtitën

dhe iu hodhën sipër dhe e mbuluan me të puthura. Gati e lanë shtatzënë. Kur vazhduam, mamaja ime tha: ‘Ç’drejtin bëhet?! Unë jam mu këtu dhe ato gra puthin tim shoq!’”

Po babai juaj, e pyes, ç’mendonte për këtë? “Oh, të lutem”. Rodrigo nënqesh. “Gra që e puthin?” Mbledh shpatullat dhe ngre pëllëmbët, duke treguar se babai i tij nuk kishte asnjë problem me vëmendjen femërore.

“Pamja nga të tetëdhjetat është e mahnitshme, vërtet”, - García Márquez-i i tha njëherë të birit. - “E fundi po afron”. “A ke frikë?” - e pyeti Rodrigo. “Më trishton thellësisht”, - iu përgjigj i ati. Ai kishte filluar të humbiste mendjen në atë kohë dhe ishte i vetëdijshëm deri në dhembje për këtë. Njëherë, thotë Rodrigo, pastruesja e gjeti në kopsht dhe e pyeti se ç’po bënte. “Po qaj”, - iu përgjigj. - “Nuk e kupton se koka ime është mut tani?” Rilexonte librat e tij të vjetër pa e ditur se kush ishte autori. “Më pas shihet fotografinë e vet në kopertinë dhe thoshte: ‘Oh, qenka libri im? Bëj mirë ta filloj sërish.’”

I ati nuk merrte kurrë pjesë në varrime, thoshte se nuk donte t'i varroste miqtë e tij. Vdiq më 2014, në moshën 87-vjeçare, nga pneumonia. Rodrigo më tregon një foto të të atit mbuluar me një çarçaf para djegies, me trëndafilat të verdhë – lulet që adhuronte babai i tij – vendosur sipër. “Mbjaj mend që e pashë tim atë ca minuta pasi kishte vdekur dhe mendova: ‘Nuk më besohet se jeta mbaron.’ Është mendim kaq torollak”.

Ceremonia që u mbajt në Mexico City pas vdekjes së tij ishte thuasë ndodhi shtetërore. Mijëra njerëz u rreshtuan pas urnës që mbante hirin e tij. Presidenti kolumbian, Juan Manuel Santos, e nderoi si “kolumbiani më i madh që ka jetuar ndonjëherë”, ndërsa presidenti meksikan, Enrique Peña Nieto, e tërboi mamanë e Rodrigo-s duke iu referuar si “e veja”. “No soy la viuda”, - u tha të bijve më vonë. “Yo soy yo”. (“Nuk jam e veja. Jam unë”.)

Vdiq gjashtë vjet më vonë, më 2020, në kulmin e Covid-it. Hera e fundit që e pa Rodrigo ishte përmes një ekrani telefoni të plasarit. “Vdekja e prindit të dytë, - shkruan në kujtimet e tij, - është si të shohësh një natë përmes teleskopit dhe të mos e gesh më një planet që ka qenë gjithmonë aty”.

Tani që janë larguar të dy prindërit e tij, Rodrigo dëshiron t'i kishte pyetur më shumë “për gerrat e vogla në jetën e tyre”, sidomos të fëmijërive të tyre. “Mendoj për vendet e largëta në Kolumbi nga kanë ardhur. Dhe si arritën të përshtaten me një botë me famë dhe fat. Është një lojë ku zgjedh që të darkosh me çdonjërin prej figurave historike. Nëse do të mund të zgjidhja, do të darkoja me prindërit e mi në të dyzetat e tyre. As nuk mund të mendoj për një person të tretë”.

Sa për sekretet që babai i tij mori me vete në varr, Rodrigo tregon një histori të jashtëzakonshme kur babai i tij pagoi të emën që t'i kthente gjithë letrat që i kishte shkruar para se të martohehin. “Ia bleu për 500 pesos kolumbiane në atë kohë”, - thotë. Më e habitshmja, kjo ishte në vitet pesëdhjetë, shumë përpara se të bëhej i famshëm. Pra, pse e bëri? “Hajde merre vesh”, - thotë Rodrigo. - “Kush do t'ia dijë? Por them se ai. Jetojmë në një epokë ku çdo gjë është publike. Dhe mendoj se është në rregull që disa gjëra të mos dihen kurrë”.

Përktheu: Enxhi Hudhri



**27 SHTATORI I BUKUR**

Unë nuk kam lexuar asnjë gazetë  
Unë nuk kam parë asnjë grua.  
Unë nuk e kam hapur kutinë e postës.  
Unë nuk i kam uruar askujt një ditë të mirë.  
Unë nuk jam parë në pasqyrë.  
Unë nuk kam folur me askënd për kohët e vjetra  
Dhe as për kohët e reja. Unë nuk kam menduar mbi veten  
time.  
Unë nuk kam shkruar asnjë varg.  
Unë nuk kam vënë asnjë gur nën rrota.

**SHPESH JE TI AI, QË UNË DUA**

Shpesh je Ti ai, që unë urrej,  
megjithatë shumë rrallë.  
Ti je gjithashtu ai, prej të cilit  
unë kisha frikë.  
Ti je ai që më godet mua  
Ti je ai që më përkëdhel  
Ti je ai që, më thotë,  
çfarë mundem unë.  
Ti je ai që më pëshpërit në vesh.  
Gjithçka je ti.  
Por ti nuk do të jesh kurrë,  
ai që do të qëndrojë këtu përgjithmonë.

**LAJMËTARI**

Ai kishte një rrugë të shkurtër. Askush  
nuk e kishte detyruar atë.  
Ai nuk kishte asnjë pengesë  
për të kapërcyer. Ai nuk kishte  
asnjë lajm për të njoftuar. Përse  
qëndronte ai tmerrsisht i ngutur  
te porta e shtëpisë.

**FOR FUN**

Ah, bota është një teatër,  
Siç thotë Shekspiri, babai i të gjithëve,  
por ne duhet t'i luajmë mirë rolet tona.  
Pastaj drama e shkretë shkruan jetën.

Kundër kësaj nuk del dot askush.  
Edhe nëse ai herë pas here,  
mendon, që mund ta bëjë,  
Just for fan.

Unë i fitoj paratë e mia me lojëra,  
për to ka nevojë populli si për bukën.  
Në teatër njeriu duhet të ndjehet i lumtur  
dhe të harrojë ata që e kërcënojnë, me të vërtetë.

Kundër kësaj nuk del dot askush.

Po, të harrojmë duam ne, gjithë çfarë na dha koha:  
Varfërinë e ftohtë, burracakërinë, vetminë.  
Dhe njeriu nuk lufton, por vetëm ndjen shpirtërisht.  
Prandaj hapja atij portat e skenës që larg

Kundër kësaj nuk del dot askush.


**KËNGA PËR JO - NË**

Jo, asnjë njeri nuk është bërë,  
që ai të jetojë vetëm gjatë ditës  
dhe akoma më keq, vetëm, edhe gjatë natës.  
Ah, Sibile, mjeti ynë më i mirë kundër vetmisë  
ishite banesa jonë e përbashkët.

Jo, mos më braktis,  
mos ik nga porta,  
mos e fik këtë dritë,  
Qëndro me mua.

Jo, njeriu nuk është menduar kësisoj  
Që më të afërtit t'i bëjë llogarinë,  
Që e ka harxhuar ai vetë, Sofi,  
Kush s'mund të jetojë vetëm nuk jeton kurrë.

Jo, unë do të shkoj tani,  
po dal nga porta,  
nëse syri yt njomet në rrjetë,  
unë nuk do të qëndroj më këtu.



Poezi nga

**THOMAS  
BRASCH**

Përktheu Fatmir Alimani

**POEZIA E PAMUNDUR**

Të papërputhshmen e dua unë në një poezi: duart  
e tua të bardha, të holluara dhe ligji që të bën ty një mall

bukuria e thjeshtë e një rime dhe  
marramendja ime trutharë e telasheve të mia ekonomike,

e trembura ime nga një qen i vogël i përhirtë dhe  
gëzimi im mbi vdekjen e kufomës së fundit qeverisëse

Për këtë poezi (unë vetëm mund të mendoja)  
do të dhuroja makinën time të shkrimit.

**KAINI FLET**

Pa shiko si rri shtrirë vëllai im  
i vdekur dhe i pasur.  
Me gungën tepër thellë  
i përkulur para burrave të lartë  
as kjo nuk sjell asgjë.  
Lëre të ekzistojë,  
Ah lëre,  
kjo sjell vetëm urrejtje vëllezërisht

**MAKBETH**

O Skoci e pagjumë dita do të bëhet nata jote  
Për agimin e bardhë ti nuk ke asnjë vend  
Ne ëndërruam, i mbyllëm sytë dhe u zgjuam  
unë ledi, e ti Makbethi, dhe ne u bëmë një vrasje

ti luaj marrëzinë unë luaj kuptimin e saj  
çmenduri unë quaj atë që ne të dyve na bashkon  
Thuaj çfarë të duash unë të them ty kush jam unë  
Më jep mua gjumin unë marr armikun tënd

Nga një mbret të bësh një kufomë  
Nga një pyll një ushtri që ngre krye  
Kush nuk ka fjetur kurrë ai nuk duhet të zgjohet  
Ne duam të bëjmë diçka jo vetëm të pyesim kush është kush.

**FRAGE**

Mbas punës me makinat  
njerëzit ëndërrojnë për makinat  
përse ëndërrojnë makinat  
mbas punës me njerëzit?

**KËTU HAP GOJËN VRASËSI I PAFAJSHËM**

Gjer tek e pandijshmja. Këtë ata e quajnë britmë.  
Ai i shikon ata që shohin vdekjen e tij:  
Ankth ose tmerr : Kinski i gdhendur në gur.  
Por nuk ka vdekur akoma. Vetëm gjatë ecjes  
së kaluar duket sikur do të jetë i përjetshëm

**AH, NËSE UNË MENDOJ,  
BOTA RROTULLOHET RRETH MEJE**

Si rrotullohet toka rreth diellit  
derisa shqyen gojën  
dhe kështu veç jeta ime T Pikë B Pikë  
Do të thotë që për më tepër unë nuk jam i mirë  
dhe as për më pak se të mësosh të kuptosh,  
gjërat që unë i dua  
pra është më bukur ta bësh dikë të lumtur  
sesa ta bësh veten : fatkeq.

**MBI ARTIN**

Ndoshta është, në një dritë të hapur duke ecur  
për asgjë tjetër: unë dua që ju të më verboni:  
si i verbër unë do t'ia dal mbanë , duke u lutur  
për pafajësinë time, dhe krimi nuk merr fund kurrë.

kush dëshiron tjetër gjë, duhet t'i largojë duart nga zjarri.  
Përndryshe do të shpërthejë gjithçka në thërmija.

Dhe unë. Unë nuk jam asgjë më shumë se sytë e mi.

Nëse ju varrosni dy persona, kë varrosni ju.  
Unë nuk kam përjetuar asgjë. Vetëm diçka kam parë.  
Unë nuk dua të vdes. Vetëm të jem i vlefshëm.

**FILOZOFËT**

Filozofët flasin për një botë  
të mundshme.  
Unë përshëndes  
filozofin Wolfgang Heise  
Nesër  
unë ndoshta jam i vdekur.  
Qentë ikin tutje  
unë  
jo

**PAUZË**

Papritur heshtën makinat  
Dhe në qetësi dëgjohet:  
Ato nuk kanë më asgjë më tepër për të thënë

**ATJE**

Çfarë unë kam, nuk dua ta humbas, por  
atje ku jam, nuk dua të qëndroj, por  
atë që unë e dua , unë nuk dua ta harroj, por  
ata që unë i njoh nuk dua t'i shoh kurrë më, por  
atje ku unë jetoj, atje nuk dua të vdes, por  
atje ku unë vdes, atje nuk dua të shkoj:  
Unë dua të qëndroj atje, ku unë nuk kam qenë kurrë.

**NDARJA OSE NJË ZGJEDHIM**

unë do të qeverisem  
ti do të qeverisesh  
ai do të qeveriset  
ju do të qeveriseni  
ai do të qeveriset  
ne do të qeverisemi  
ju do të qeverisni  
ata qeverisin

**ZOTI**

Tepër i majmë rri shtrirë Zoti i mirë  
në shtratin e tij qiellor.  
Ai fle dhe ëndërron  
për gratë e zbehta  
që natës lakuriq,  
e shikojnë nga dritarja  
dhe pëshpëritin fjalë të mprehta

Romani i panjohur i Markezit do të botohet  
në të gjithë botën **(në shqip nga Onufri)**,  
në të njëjtën ditë: 6 mars 2024

